MANUAL

PËR HARTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE KAPITALE (PIK)

Manual për Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit
Adresa: Rr. Pashko Vasa, Nr. 20
K.P. 2995, Tiranë.
Web: www.co-plan.org

Të gjitha të drejtat të rezervuara Co-PLAN,
Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Botimi i parë viti 2008

Ribotuar, Shtator 2010

Realizimi Grafik:

Shtypur në:

MANUALI PËR HARTIMIN E
PLANIT TË INVESTIMEVE KAPITALE NGA
NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Manuali për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale për Njesitë e Qeverisjes Vendore u përgatit në kuadër të projektit "Mundësimi i qeverisjes së mirë nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar bashkiak" nën programin NOSA 2008 dhe programit "Mundësimi i qeverisjes së mirë urbane - vazhdim", zbatuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit gjatë vitit 2007 – 2008, në bashkitë e Fierit, Durrësit dhe Lezhës, në partneritet me Shoqatën e Bashkive Shqiptare.

Manuali është rishikuar dhe plotësuar duke iu referuar eksperiencës së fituar gjatë hartimit të dokumentit të Planit të Investimeve Kapitale në bashkitë e Shkodrës, Korçës dhe Beratit në kuadër të programit "Vazhdimi i Mbështetjes në Bashkitë DELTA: Durrës, Lezhë, Shkodër, Korçë dhe Berat – Plani i Investimeve Kapitale" financuar nga Inisiativa për Qeverisjen Lokale dhe Reformën në Shërbimet Publike / Instituti për Shoqërinë e Hapur – Budapest.

OPEN SOCIETY FOUNDATIONS dhe Local Government and Public Service Reform Initiative

Manuali për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale u përgatit nga ekspertët e përfshirë në projektin "Mundësimi i qeverisjes së mirë nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar bashkiak" nën programin NOSA 2008 dhe programin "Mundësimi i qeverisjes së mirë urbane - vazhdim" në vitin 2008. Ai u rishikuar dhe përmirësua në kuadër të programit "Vazhdimi i Mbështetjes në Bashkitë DELTA: Durrës, Lezhë, Shkodër, Korçë dhe Berat – Plani i Investimeve Kapitale"

Falënderime të veçanta, për hartimin e këtij materiali, u drejtohen kryetarëve të: Bashkisë së Beratit, Z. Fadil Nasufi; Bashkisë së Durrësit, Z. Vangjush Dako; Bashkisë së Fierit, Z. Baftjar Zeqaj; Bashkisë së Lezhës, Z. Viktor Tusha; Bashkisë së Korçës, Z. Niko Peleshi dhe Bashkisë së Shkodrës, Z. Lorenc Luka; të cilët me lidershipin e tyre kanë garantuar koordinimin e procesit të hartimit të Planeve të Investimeve Kapitale ne bashkitë përakatëse.

Informacioni i përdorur për përgatitjen e këtij materiali është kontribut i të gjithë specialistëve të përfshirë në grupet lehtësuese të PIK të ngritura në bashkitë e angazhuara në këtë projekt.

Bashkia Berat | Bashkia Durres | Bashkia Fier | Bashkia Lezhë | Bashkia Korçë | Bashkia Shkodër

Autorët: Anila Gjika (Co-PLAN)
Altin Mihali (Co-PLAN)

Editues Përmbajtësor: Dritan Shutina (Co-PLAN)

Kontribues Përmbajtësor: Etleva Goxhaj (Co-PLAN)
Evgjeni Pelivani (Bashkia Berat)
Ardian Çela (Bashkia Durrës)
Jani Fuli (Bashkia Fier)
Arjan Barbullushi (Bashkia Lezhë)
Sotiraq Filo (Bashkia Korçë)
Ahmet Omi (Bashkia Shkodër)

TABELA E LËNDËS

HYRJE 7
1.1 Kujt mund t'i shërbejë ky manual?
1.2 Sa kohë nevojitet për hartimin e PIK?
1.3 Cilat burime financiare nevojiten për përdorimin e këtij manuali?

QASJA E CO-PLAN PËR HARTIMIN E PIK 11
2.1 Si mund ta përdorni këtë manual?

KAPITULLI I: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PIK 13
1.1 Çfarë është Plani i Investimeve Kapitale (PIK)
1.2 Pse hartohet Plani i Investimeve Kapitale?
1.3 Cilat janë avantazhet që sjell PIK?
1.4 Cilat janë hapat për hartimin e PIK?

KAPITULLI II: ZHVILLIMI I METODOLOGJISË DHE POLITIKAVE TË PIK 21
2.1 Dizenjimi i procesit për hartimin e PIK
2.2 Zhvillimi i politikave të PIK

KAPITULLI III: IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE TË PIK 27
3.1 Hapat për evidentimin e projekteve kapitale në njësitë vendore

KAPITULLI IV: VLERËSIMI I AFTËSISË SË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE PËR TË FINANCUAR PIK 31
4.1 Mundësitë e financimit të investimeve kapitale
4.2 Partneriteti Publik – Privat si një nga format kryesore të financimit të Investimeve Kapitale
4.3 Analiza e mundësive të financimit
4.4 Analiza e historikut financiar të njësisë vendore
4.5 Llogaritja Analitike e të ardhurave të njësisë vendore
4.6 Plani i Investimeve Kapitale dhe Programi Buxhetor Afatmesëm

KAPITULLI V: INVESTIMET KAPITALE DHE KRITERET PËR PRIORITARIZIMIN E TYRE 43
5.1 Metodologjia per prioritarizimin e projekteve kapitale
5.2 Investimet Kapitale dhe cikli i projektit
5.3 Investimet Kapitale dhe analiza kosto - përfitim
5.4 Kriteret për përzgjedhjen e projekteve prioritare në PIK

KAPITULLI VI: PËRGATITJA E DOKUMENTIT TË PIK 55
6.1 Përgatitja e dokumentit të PIK
6.2 Përmbajtja e dokumentit të PIK dhe miratimi i tij

KAPITULLI VII: MONITORIMI I PIK 57

KAPITULLI VIII: PLANI I VEPRIMIT DHE KALENDARI PËR HARTIMIN E PIK 61

ANEKSE 64

REFERANCAT 78

HYRJE

Në kushtet aktuale pushtetet vendore po ndeshen me sfida të mprehta për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kapaciteteve vendore përsa i përket aspekteve financiare dhe administrative. Nevoja për përmiresim vjen si pasojë e një seri iniciativash të ndërmarra nga pushteti qendror si: decentralizimi i kompetencave për ofrimin e shërbimeve publike, legalizimin e zonave informale dhe nevojat për ndërtimin dhe menaxhimin e bazës së informacionit. Nga ana tjetër, nisur nga kërkesat e pushteteve vendore për të marrë më shumë përgjegjësi dhe kompetenca, është vënë re një nevojë për procese me pjesëmarrje për angazhimin e shoqërisë civile, nevojë për transparencë dhe përgjegjshmëri sociale. Në këtë kuader, çështjet e menaxhimit finaciar bashkiak mbeten thelbësore për të gjitha autoritetet vendore, ku veçanërisht qytetet e mëdha administrative manifestojnë një nevojë të vazhdueshme për një menaxhim sa më të mirë dhe efiçent të të ardhurave dhe shpenzimeve. Co-PLAN gjate angazhimit të tij tre-vejçar, duke punuar pranë Bashkisë së Fierit dhe asaj të Elbasanit, nëpërmjet projektit "Mundësimi i Qeverisjes së mirë Urbane" (EGUG II), ka krijuar eksperiencë të mirë në fushën e qeverisjes urbane dhe ngritjes së kapaciteteve vendore duke zhvilluar dhe zbatuar *Strategjitë e Zhvillimit të qyteteve, Planet Rregulluese Urbane dhe Planet e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe Menaxhimit të Sistemit të Informacionit.*

Ky program, ka hapur rrugë të reja për zhvillimin e fushës së qeverisjes urbane në Shqipëri. Modelet e krijuara nëpërmjet këtij programi kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e disa projekteve të tjera, kësaj radhe të financuar jo vetëm nga Ambasada e Vendeve të Ulëta, por edhe nga Fondacioni SOROS në Shqipëri dhe LGI në Budapest. Nëpërmjet këtyre projekteve, synohet mundësimi i qeverisjes së mirë lokale nëpërmjet

përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar bashkiak. Projektet e financuar nga SOROS në Shqipëri dhe LGI në Budapest fokusohen në bashkitë të cilat kanë qenë përfituese të programit DELTA Berat, Durrës, Lezhë, Korçë dhe Shkodër. Ndërsa projekti i financuar nga Qeveria Hollandeze përmes Ambasadës së vendeve të Ulëta në Tiranë, është fokusuar në bashkitë e Fierit dhe të Elbasanit.

Ne kuadër të këtij programi, një nga objektivat kryesore që është synuar të realizohet në Bashkitë në fjalë, është hartimi i Planit të Investimeve Kapitale, si një nga instrumetat kryesorë në duart e pushtetit lokal që mundëson përkthimin në terma financiare dhe kohore të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal të qytetit. Plani i Investimeve Kapitale shumëvjeçar, shumë i diskutuar kohët e fundit, shërben si një strategji "kyç" për të rritur efiçencën dhe stabilitetin e qeverisjes lokale. Planet e Investimeve Kapitale (PIK) mundësojnë një kontroll më të mirë lokal për prioritarizimin e investimeve, ndërkohë që sigurojnë një marëdhënie transparente me komunitetin lokal.

Co-PLAN, nëpërmjet programeve "Mundësimi i qeverisjes së mirë nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar bashkiak" dhe "Mundësimi i qeverisjes së mirë urbane - vazhdim" është angazhuar në zbërthimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal të qytetit të Fierit, Durrësit dhe Lezhës në një Plan të qartë Investimesh Kapitale. Kjo eksperiencë është replikuar dhe zhvilluar më tej në bashkitë e Beratit, Korçës dhe Shkodrës, në kuadër të programit "Vazhdimi i Mbështetjes në Bashkitë DELTA: Durrës, Lezhë, Shkodër, Korçë dhe Berat – Plani i Investimeve Kapitale" financuar nga Inisiativa për Qeverisjen Lokale dhe Reformën në Shërbimet Publike / Instituti për Shoqërinë e Hapur – Budapest

Manuali që ju keni në dorë, është sintezë e punës së bërë në bashkitë në fjalë, në një përpjekje për të përgjithësuar dhe Standardizuar hapat që njësitë e qeverisjes vendore mund të ndjekin gjatë procesit të hartimit të Planit të Investimeve Kapitale. Ky dokument, mund të përdoret si referencë për të projektuar procesin e hartimit të PIK në konteksin e njësisë vendore, në përgatitjen e dokumentit përfundimtar të Planit të Investimeve Kapitale për miratim, e më tej gjatë zbatimit e monitorimit të tij.

1.1 Kujt mund t'i shërbejë ky manual?

Plani i Investimeve Kapitale ndihmon për të koordinuar dhe harmonizuar programet për investime të njësive të qeverisjes vendore me ato të iniciuara nga autoritetet e pushtetit qëndror, duke bërë të mundur përdorimin më efiçent të burimeve financiare. Përdorimi i këtij instrumenti mundëson dhe siguron edhe bashkëpunimin midis qytetarëve, biznesit dhe donatorëve të ndryshëm.

Planet e Investimeve Kapitale konsiderohen si instrumenta legjitim të menaxhimit sepse hartohen dhe aprovohen nga qytetarët, për këtë arsye, shërbejnë për të tërhequr donatorët e huaj dhe investitorët potencialë.

Veç këtyre, ky manual vjen si një përpjekje për të adresuar nevojën që çdo njësi e qeverisjes vendore has për të bërë më efiçent menaxhimin e fondeve të destinuara për investime. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të përgatisin buxhete afatmesme, të cilat i dërgohen qeverisë qëndrore. Shpesh këto buxhete hartohen brenda departamenteve të financave dhe nuk paraqesin nevojat reale të njësive vendore. Plani i Investimeve Kapitale prezantohet si një instrument, i cili mund të plotësojë dhe zëvendësojë këtë kërkesë të qeverisjes qëndrore.

Plani i Investimeve Kapitale shërben edhe për monitorimin e projekteve dhe të fondeve, jo vetëm nga qytetarët por edhe nga Këshilli Bashkiak. Ky i fundit miraton PIK çdo vit sipas ndryshimeve përkatëse dhe e bën atë një dokument legjitim.

1.2 Sa kohë nevojitet për hartimin e PIK?

Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale për një periudhë katër-vjeçare, siç shtjellohet më tej në këtë material, mbështetet në një plan veprimi. Koha që nevojitet për përgatitjen e Planit të parë të Investimeve varion sipas njësive të qeverisjes vendore. Variablat të cilët ndikojnë në këtë proces janë: madhësia e njësisë vendore, grupi i punës i angazhuar në proces, struktura institucionale, eksperiencat e njësisë në lidhje me hartimin e strategjive të zhvillimit lokal, ekzistenca apo mungesa e dokumenteve të strategjive, projekteve kapitale, etj. Nga eksperienca që Co-PLAN ka patur me bashkitë e përmendura më sipër, ka rezultuar se koha që nevojitet për të gjithë procesin e PIK varion nga shtatë deri në dhjetë muaj, gjatë një viti.

Secili nga hapat e procesit ka nevojë për një sasi të caktuar kohe gjatë hartimit të PIK. Veç kësaj, meqënëse PIK është një plan shumëvjeçar, dokumentat përbërës të tij kanë nevojë për rishikime dhe përshtatje, të cilat bëhen përgjatë çdo viti buxhetor, në funksion të kërkesave të reja.

1.3 Cilat burime financiare nevojiten për përdorimin e këtij manuali?

Sa herë flitet për proces planifikimi, burimet kryesore të nevojshme janë burimet njerëzore dhe koha. Eksperienca e Co-PLAN në bashkitë e mësipërme dëshmon se një përqasje sipas të cilës proçesi të drejtohet nga një grup shumë-disiplinor, i cili mbulon çështje specifike të

qeverisjes vendore: buxhetin, hartimin e projekteve dhe preventivave për investimet, planifikimin urban dhe zhvillimin strategjik, taksat vendore dhe grumbullimin e tyre, asetet vendore, programet apo projektet e donatorëve, etj., rezulton i suksesshëm. Në çdo rast, i takon vetë qeverisë vendore të përcaktojë madhësinë dhe përbërjen e grupit të punës, si dhe kohën në dispozicion për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale. Në kontekstin e burimeve financiare në dispozicion të realizimit të PIK fokusi i njësive vendore orientohet në angazhimin e burimeve të sigurta, të ardhurave të veta kapitale krijuar si diferencë e të ardhurave dhe shpenzimeve.

QASJA E CO-PLAN PËR HARTIMIN E PIK

Duke qënë se procesi i decentralizimit është duke u thelluar dhe njësitë e qeverisjes vendore janë duke marrë gjithmonë e më tepër kompetenca, sfida kryesore e tyre mbetet plotësimi i nevojave për investime nëpërmjet të ardhurave të limituara. Së fundmi, qeverisja vendore në Shqipëri ka bërë përparime të ndjeshme në fushat e zhvillimit ekonomik lokal dhe planifikimit strategjik, megjithatë, problemi i "projekteve të pafinancuara" mbetet shqetësimi kryesor për zbatimin e strategjive. Për këtë arsye ka lindur nevoja për politika të qarta në financimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillimin ekonomik lokal si një instrument i rëndësishëm zhvillimi dhe qeverisje të mirë.

Veç kësaj, të gjithë aktorët po bëjnë përpjekje për plotësimin dhe përmirësimin e reformës mbi decentralizimin fiskal, dhe zhvillimi më i fundit mbi temën lidhet me përgatitjen e ligjit të ri mbi menaxhimin financiar. Në këtë pikë, Plani i Investimeve Kapitale është një mekanizëm substancial për të përmirësuar menaxhimin financiar bashkiak dhe për

të shndërruar planet strategjike në plane veprimi, duke ndikuar në këtë mënyrë kapacitetet vendore dhe në të njëjtën kohë duke mundësuar rritjen e të ardhurave lokale. Plani i Investimeve kapitale impakton në qeverisjen efektive, përmirëson transparencën në lidhje me financat bashkiake, dhe përmirëson imazhin e vendimmarrjes, ndërkohë që shërben si një pikënisje për monitorimin dhe zbatimin e dokumentave strategjikë.

2.1 Si mund ta përdorni këtë manual?

Ky dokument, Manuali për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale nga njësitë e qeverisjes vendore, siguron një grup instrumentash dhe teknikash bazike, për t'iu përgjigjur nevojave të qeverisjes vendore në të gjithë vendin. Për të gjitha ato njësi të qeverisjes vendore, të cilave ju duhet të hartojnë për herë të parë një plan për investimet kapitale, ky manual ofron një udhëzues hap pas hapi për të projektuar, zbatuar dhe mbikqyrur një plan investimesh kapitale. Për njësitë vendore që kanë përgatitur një PIK dhe do të dëshironin të përmirësonin procesin, manuali ofron tekninka dhe shembuj nga procesi të cilat mund të rezultojnë të nevojshme për to.

Hapat e përshkruar në dokument synojnë të mbulojnë të gjitha aktivitetet që mund të ndërmerren gjatë procesit të hartimit të Planit të Investimeve Kapitale. Njësitë më të vogla të qeverisjes lokale mund ta modifikojnë procesin dhe të përzgjedhin prej tij vetëm ato hapa të cilat rezulojnë efiçenete në kontekstin në fjalë. Njësi të tjera, më të mëdha, në mungesë të strategjive të miratuara të zhvillimit, mund të duan të shtojnë hapat e këtij procesi, apo të modifikojnë kohëzgjatjen për faza të veçanta. Në çdo rast, pavarësisht nga modifikimet që mund t'i bëhen procesit, rezultati final do të jetë një plan i cili adreson në mënyrën e duhur nevojat për investime kapitale dhe që garanton mbështetjen e të gjitha palëve; qeverisjes lokale, qytetarëve, biznesit, etj.

KAPITULLI I
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PIK

1.1 Çfarë është Plani i Investimeve Kapitale (PIK)?

Plani i Investimeve Kapitale (PIK) është një plan shumëvjeçar – zakonisht katër ose pesë vjet – i cili hartohet nga organi i qeverisjes vendore dhe identifikon projektet kapitale dhe mënyrën se si këto projekte do të financohen.

PIK identifikon të gjitha pasuritë/asetet publike lokale që do të rehabilitohen, rinovohen apo rikonstruktohen, vitin në të cilin do të kryhet ndërhyrja, vlerën (në lek) e parashikuar të shpenzohet për secilin nga projektet dhe mënyrën e propozuar për të financuar projektet. Në shumicën e rasteve ky informacion paraqitet në një tabelë përmbledhëse në të cilën paraqiten shpenzimet kapitale për çdo vit, të zbërthyera sipas programeve, sektorëve apo mënyrës së financimit.

Plani i Investimeve Kapitale, pavarësisht se hartohet për një periudhë katër-pesë vjeçare rishikohet çdo vit dhe rekomandohet që të miratohet prej Këshillit Bashkiak.

Plani i Investimeve Kapitale nuk duhet të ngatërrohet me buxhetin për investimet kapitale. Buxheti për Investimet Kapitale përfaqëson vitin e parë të Planit të Investimeve Kapitale. Buxheti Kapital autorizon projektet specifike që do të zbatohen gjatë vitit të parë të PIK dhe shpjegon alokimin e fondeve për këto projekte. Ai përshtatet me buxhetin operativ të njësisë së qeverisjes vendore dhe ofron mundësinë për të operuar me projektet specifike. Projektet dhe burimet financiare të listuara në PIK për vitet e tjera veç vitit të parë nuk janë të autorizuara deri sa buxheti vjetor për këto vite të hartohet e specifikohet.

1.2 Pse hartohet Plani i Investimeve Kapitale?

PIK është një ndër kontribuesit kryesorë në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik. Ai mund t'u shërbejë disa funksioneve të rëndësishëm në njësitë e qeverisjes vendore. Këto përfshijnë:

PIK siguron një pasqyrë integrale të nevojave dhe mundësive: Një nga funksionet kryesore të PIK është që të sjellë së bashku stafin e njësisë vendore të interesuar/angazhuar në investime, duke përfshire ata që punojnë drejtpërsëdrejti me investimet, por edhe departamentet e tjerë, më pak të përfshira në këtë proçes. Së bashku këta departamente mund të zgjedhin se çfarë të blejnë, të ndërtojnë, riparojnë, dhe si t'i financojnë këto kosto.

PIK siguron një instrument të menaxhimit financiar: Një ndër shqetësimet kryesore në hartimin e PIK është prioritarizimi i nevojave të tanishme dhe të ardhshme në përshtatje me mundësitë dhe limitet finaciare të njësisë të qeverisjes vendore. PIK merr në konsideratë jo vetëm atë për të cilën një komunitet ka nevojë, por në të njëjtën shkallë rëndësie, atë që ky komunitet mund të përballojë. Hartimi i një PIK, bazuar në parashikime realiste për financimin e investimeve, nisur nga mundësitë është i ndryshëm nga nga hartimi i një "liste dëshirash" me projekte të cilët nuk do kenë mundësi të zbatohen. PIK e vendos njësinë vendore në kontroll të të gjitha vendimeve për investime.

PIK shërben si një dokument raportues: Dokumenti i hartuar gjatë proçesit të hartimit të PIK garanton një përshkrim të qartë të projekteve të parashikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës së planifikuar. Ky dokument u paraqet qytetarëve, bizneseve, dhe aktorëve të tjerë të interesuar në qytet prioritetet e njesisë së qeverisjes vendore për investime dhe planet për projektet e ardhshme. Komuniteti, ka në këte mënyrë, një panoramë

më të qartë të planit të qeverisjes lokale për investime kapitale dhe mund të marrë vendime mbi bazën e një informacioni më të plotë.

Tabela 1.

PIK - Plan shumëvjeçar (4-5vjet) i hartuar nga Pushteti Lokal.
PIK identifikon:

i. Pasurinë (assetin) që do të rehabilitohet, rikonstruktohet, rinovohet;
ii. Vitin/vitet kur do të fillojë/zbatohet;
iii. Koston që do të kërkojë;
iv. Mënyrën e propozuar të financimit të investimit.

PIK prezantohet si një pasqyrë përmbledhëse që përfshin shpenzimet për çdo vit të detajuara sipas: (i) Programit të përgjithshëm; (ii) Sektorit kryesor; (iii) Mënyres së financimit.

PIK miratohet nga Këshilli Bashkiak.

PIK (i) Siguron një pamje të përgjithshme të nevojave dhe mundësive; (ii) Siguron një instrument te menaxhimit financiar; (iii) Përdoret si një mënyrë dokumentimi dhe raportimi.

1.3 Cilat janë avantazhet që sjell PIK?

Janë të shumta avantazhet që njësia e qeverisjes lokale mund të përftojë nga hartimi dhe përdorimi i një Plani të Investimeve Kapitale. Ato renditen më poshtë:

PIK fokuson vëmendjen në qëllimet e qeverisjes vendore, nevojat dhe mundësitë financiare të saj: Nëpërmjet procesit të PIK, autoritetet lokale zgjedhin projektet prioritare të cilat duhet të jenë në konsistencë me nevojat dhe qëllimet e komunitetit. Si pjesë e procesit, qeverisja lokale, duke iu referuar strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal, rithekson prioritetet dhe nevojat e komunitetit dhe biznesit. Po ashtu, nëpërmjet PIK analizohet mënyra më e mirë për të financuar investimet, duke konsideruar kapacitetin e përballimit të kredisë prej njësisë së qeverisjes vendore dhe në të njëjtën kohë shkallën deri në të cilën një pjesë e projekteve mund të mbulojnë kostot e tyre (gjenerojnë të ardhura të

shpejta). Ky proces shërben si bazë për të mundësuar që investimet në infrastrukturë të përfshihen në planin kapital dhe nga ana tjetër shërben për të balancuar nevojat e komunitetit duke ofruar shansin për të financuar këto projekte nëpërmjet të gjitha burimeve të mundëshme të financimit.

PIK siguron një sensibilizim publik në shkallë të gjerë mbi nevojat për hartimin e një planifikimi lokal efektiv: Një nga komponentët më të rëndësishëm gjatë hartimit të PIK është përfshirja e qytetarëve në përzgjedhjen, seleksionimin dhe prioritarizimin e projekteve. Pjesëmarrja e komunitetit ndihmon për të siguruar mbështetje për projektet kapitale duke qënë se procesi i krijon mundësi publikut në kuptimin në shkallë të gjerë të nevojave të të gjithëve dhe të mundësive për përballimin e këtyre nevojave. Në këtë mënyrë komuniteti e mbështet këtë proces dhe siguron legjitimitetin e tij.

Nëpërmjet PIK përmirësohet komunikimi dhe bashkëpunimi i stafit lokal të përfshirë në procesin e hartimit të programit të investimeve kapitale: Procesi i hartimit të PIK ndihmon për të përmirësuar bashkëpunimin dhe komunikimin mes stafit teknik dhe atij financiar, si brenda bashkisë, ashtu edhe në Këshillin Bashkiak. Duke punuar së bashku për të koordinuar dhe planifikuar investimet kapitale, afatet, financimin dhe zbatimin e tyre, një projekt përgatitet në formë më të plotë dhe me të gjithë elementet e tij. Kuptohet se koordinimi i aktiviteteve të PIK, bën të mundur që ai t'i shërbejë në mënyrën më të mirë interesave të gjithë komunitetit, dhe jo vetëm interesave të ngushta të një grupi apo njësie të qeverisjes lokale.

PIK ndihmon qeverisjen vendore të shmangë gabimet e kushtueshme për investimet në infrastrukturë: PIK mund t'i shërbejë qeverisjes

vendore për të shmangur gabimet e kushtueshme të projekteve që mund të rezultojnë në dështime si rezultat i mosplotësimit/lidhjes me projektet e tjera pasuese, ose si rezultat i mungesës së fondeve të nevojshme. Për faktin se projektet konsiderohen gjatë një periudhë disavjeçare, dhe jo më në një vit, njësitë vendore janë në gjendje të ndërtojnë skenarë më të sigurtë për investimet para se te vendosin për shpenzimet në to. Po ashtu, PIK inkurajon dhe mundëson shtrirjen e një projekti në kohë nisur nga burimet financiare të sigurura në afate të ndryshme kohore.

PIK ndihmon njësinë e qeverisjes vendore të rrisë stabilitetin dhe performancën financiare: Duke parashikuar burimet financiare të nevojshme për projektet kapitale, PIK mund të ndihmojë për të garantuar stabilitetin finaciar në njësinë vendore. Projektet kapitale të prioritarizuara nëpërmjet tij dhe te vendosura në kohë sipas nivelit të të ardhurave, ndihmojnë drejtuesit lokal që të marrin vendime të sakta në lidhje me çështje të financave vendore.

PIK shërben njëkohësisht si programi buxhetor afatmesëm i orientuar drejt investimeve kapitale. Si i tillë ai siguron lidhjen mes strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale me objektivat dhe programet afatmesëm në nivel vendor. Si i tillë PIK hartohet mbi një sërë programesh strategjike të cilat synojnë:

Zgjerimin e ekonomisë në funksion të rritjes së të ardhurave dhe krijimin e mundësive të punësimit përmes një game të gjerë instrumentesh të cilët mundësojnë realizimin e këtij prioriteti.

Përmirësimin e infrastrukturës publike në nivel vendor përmes organizimit të pjesëmarrjes së komunitetit me fokus kryesor rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese.

Ngritjen e kapaciteteve dhe forcimit institucional për të zgjeruar akoma më tej zhvilluar, organizuar dhe forcuar bashkëpunimin me komunitetin me qëllim mobilizimin e iniciativave të përbashkëta duke siguruar përfshirjen e tyre jo vetëm në bashkëfinancim por në të gjitha fazat e tjera të procesit si përzgjedhjen e projekteve, zbatimin dhe menaxhimin.

Përmirësimin e programeve të lidhura me krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm. Aktivitetet e identifikuara në nivel qendror do mund të përkthehen në programe konkrete lokale të cilat do të jenë në gjendje të vetëfinancojnë kostot e tyre nga të ardhurat që gjenerojnë (ujësjellës - kanalizime, pastrim, gjelbërim etj)

Tabela 2.

Avantazhet e Planit të Investimeve Kapitale janë:

- Fokuson vëmendjen në qëllimet, nevojat dhe mundësitë financiare të qeverisjes lokale
- Siguron një sensibilizim publik në shkallë të gjërë mbi nevojat për hartimin e një planifikimi lokal efektiv
- Përmirëson bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet stafit lokal të përfshirë në procesin e hartimit të tij
- Ndihmon qeverisjen vendore të shmangë gabimet në llogaritjen e kostove të infrastrukturave
- Ndihmon qeverisjen lokale në rritjen e qëndrueshmërisë financiare
- Ndihmon qeverisjen vendore në krijimin e mjedisit të qëndrueshëm social dhe ekonomik
- Përmirëson infrastrukturën publike në nivel vendor nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes qytetare
- Zgjeron akoma më tej kapacitetet vendore në përmbushjen e angazhimeve dhe prioriteteve

1.4 Cilat janë hapat për hartimin e PIK?

Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale përfshin disa hapa të rëndësishëm të cilët bëjnë të mundur zbatimin e këtij dokumenti. Ndërkohë që hapat janë të ngjashëm për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, vetë procesi i hartimit të PIK mund të ndryshojë në funksion të madhësisë së njësisë

së qeverisjes vendore, politikave të saj në përfshirjen e komunitetit, strukturës organizative, madhësisë së njësise (numrit të stafit), gjendjes fiskale, etj. Çdo njësi vendore mund të përshtasë një model të vetin në funksion të variablave të përmendur më sipër dhe për të garantuar arritjen e qëllimeve dhe objektivave të saj ne hartimin e PIK. Ky model përgatitet nga njësia vendore dhe nëse shikohet e arsyeshme miratohet nga këshilli përkatës bashkiak.

Në përgjithësi Plani i Investimeve Kapitale është i organizuar në pesë hapa, të cilët në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur më poshtë. Secili nga hapat, detajohet më tej në materialin në vijim.

1) Hartimi dhe zhvillimi i metodologjisë dhe politikave të PIK
2) Identifikimi i projekteve të mundshme PIK
    i) Analizë e portofolit të projekteve të strategjisë së zhvillimit të qytetit
    ii) Analizë e situates ekzistuese dhe në vazhdimësi në qytet
    iii) Rishikimi i projekteve të miratuara më parë
3) Identifikimi i burimeve të ndryshme për financimin e investimeve
4) Kategorizimi dhe prioritarizimi i projekteve
    i) Procesi i prioritarizimit
    ii) Metodologjia
    iii) Përgatitja dhe adoptimi i një PIK shumëvjeçar
5) Procesi i monitorimit të PIK.

Figura 1. Skema e hapave për hartimin e PIK prej NJQV-ve




Tabela 3.

Përfundim:
Plani i Investimeve Kapitale është i organizuar në pesë hapa, si më poshtë: 1. Hartimi dhe zhvillimi i metodologjisë dhe politikave të PIK 2. Identifikimi i projekteve të mundshme PIK i. Analizë e portofolit të projekteve të strategjisë së zhvillimit të qytetit ii. Analizë e situates ekzistuese dhe në vazhdimësi në qytet iii. Rishikimi i projekteve të miratuara më parë 3. Identifikimi i burimeve të ndryshme për financimin e investimeve 4. Kategorizimi dhe prioritarizimi i projekteve i. Proçesi i prioritarizimit ii. Metodologjia iii. Përgatitja dhe adoptimi i një PIK shumëvjeçar 5. Procesi i monitorimit të PIK.

Kapitulli II
Zhvillimi i metodologjisë dhe politikave të PIK

1.1 Dizenjimi i procesit për hartimin e PIK

Nisur nga rëndësia dhe roli strategjik që Plani i Investimeve Kapitale ka, hartimi dhe zhvillimi i tij, si çdo proces tjetër kërkon një plan të qartë aktivitetesh dhe kohë të mjaftueshme për ta zbatuar atë.

Njësitë e qeverisjes vendore duhet të ndërtojnë një strukturë brenda njësisë së tyre për të menaxhuar procesin e për hartimin e PIK. Përgjegjësitë për organizimin e procesit të PIK ndryshojnë në funksion të nevojave të njësisë vendore, apo të komunitetit, por ajo që është e rëndësishme është identifikimi i përgjegjësit për procesin. Pa një kuptim të qartë se kush e drejton procesin ai mund të rezultojë konfuz dhe joefiçent.

Një nga detyrat kryesore që shtrohet para njësisë së qeverisjes vendore të interesuar në hartimin e PIK është caktimi i një lehtësuesi për hartimin e PIK. Lehtësuesi mund të jetë një individ, ose një komitet-grup pune, i krijuar brenda bashkisë në funksion të hartimit të PIK.

Lehtësuesi është përgjegjës për të garantuar se procesi për hartimin e PIK ecën sipas planit të hartuar dhe proçedurave të përcaktuara në fillim të procesit. Koordinimi dhe komunikimi janë elementë të rëndësishëm të PIK sepse në hartimin e tij mund të përfshihen shumë aktorë. Për këtë arsye lehtësuesi (grupi i punës/komiteti i PIK) merr një rëndësi të veçantë, duke u shndërruar në figurën përfaqësuese të procesit.

Lehtësuesi i PIK duhet të jetë një individ apo grup individësh të cilët njohin procesin e hartimit të PIK dhe garantojnë zbatimin e tij në të gjitha fazat e parashikuara deri në finalizimin e procesit.

Përgjegjësitë e lehtësuesit të procesit (grupit të punës/komitetit të PIK) janë renditur më poshtë:

- Lehtësuesi i PIK harton dhe zhvillon metodologjinë e PIK
- Përgatit kalendarin e PIK
- Ndihmon në përgatitjen për listën e projekteve
- Vlerëson mundësitë e fianancimit të projekteve të propozuara hap pas hapi duke garantuar:
    - Identifikimin e burimeve të të ardhurave për projektet kapitale. Këtu mund të futen të ardhurat që sigurohen vetëm një herë si p.sh. nga shitje prone, etj.
    - Krijimin dhe sigurimin e të ardhurave për zëvendësimin e pajisjeve kapitale
- Drejton procesin e identifikimit dhe prioritarizimit të projekteve kapitale që do të përfshihen në PIK dhe përgatitjen e kërkesave që duhet të plotësojë një projekt për t'u klasifikuar si Investim Kapital (kriteret e përzgjedhjes)
- Përgatit formën/modelin e prezantimit të PIK për aprovim nga Këshilli Bashkiak dhe e mbron atë në keshill.
- Monitoron zbatimin e procesit hap pas hapi.

Në çdo rast, por veçanërisht kur lehtësuesi i PIK është një komitet/ grup pune i formuar brenda bashkisë, është e nevojshme që në të të përfshihen drejtuesit ose specialistë që kanë të gjithë informacionin e nevojshëm nga departamentet si më poshtë:

- Departamenti i Finanacave
- Departamenti i Shërbimeve Publike (përfshirë këtu edhe Drejtorinë e Ujësjellës – Kanalizimeve)
- Departamenti i Tatim Taksave
- Departamenti i Urbanistikës
- Departamenti i Koordinimit të Strategjive (Dep. i Koordinim/Zhvillimit)

Është e rëndësishme që ky grup pune të udhëhiqet prej lidershipit të njësisë vendore për të garantuar një perqasje sa më të mirë me të gjitha nevojat e njësisë (bashkise/qytetit).

1.2 Zhvillimi i politikave të PIK

Grupi lehtësues i PIK fillimisht duhet të: (i) përcaktojë llojin e projekteve kapitale që do të përfshihen në PIK; (ii) përcaktojë periudhën që do të mbulohet nga PIK; (iii) të përgatisë një kalendar ku të evidentohen aktivitet kryesore dhe afatet e realizimit të tyre; (iv) të hartojë strategji për përfshirjen e komunitetit në proces. Ky informacion duhet të përshkruhet në një dokument që iu shpërndahet të gjithë departamenteve të njësisë vendore përfshirë edhe drejtuesit kryesorë të saj. Kjo, sepse për hartimin dhe zbatimin e PIK është e kështillueshme të ndiqen disa politika specifike, të cilat duhet të jenë të pranuara nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces.

Është shumë e rëndësishme që administrata e qeverisjes vendore të krijojë një kuptim të qartë në lidhje me klasifikimin apo jo të një investimi kapital. Kjo sepse shpeshherë, pavarësisht një lloj fleksibiliteti, nuk ka një kuptim të qartë se cili projekt/investim duhet, dhe cili nuk duhet, të përfshihet në planin e investimeve kapitale.
Atëherë, cilat mund të jenë disa prej politikave që qeverisja vendore

mund të ndjekë për lehtësimin e këtij procesi?
Politikat e vendosura janë specifike dhe variojnë sipas njësive të qeverisjes vendore, megjithatë për të krijuar një ide më të qartë mbi to, sjellim disa shembuj:

Shembull: Një politikë mund të ishte vendosja e disa kritereve bazë në ndarjen e burimeve të të ardhurave (të ardhurat + grant i pakushtëzuar) në funksion të zbatimit të PIK. (p.sh. 40% e të ardhurave në buxhet do të shkojnë për investime kapitale me qëllim që brenda një periudhe prej 4 vjetësh të sigurohet realizimi i një investimi kapital sipas parashikimit)

Shembull: Bashkia ka si prioritet sigurimin e furnizimit 24 orë me ujë për qytetarët. Mbështetur në këtë logjikë pranohet se mbi bazën e parashikimit të të ardhurave të gjeneruara në vitin aktual për investime (të cilat duhet të llogariten nga bashkia) dhe parashikimin e tyre për një periudhë disa vjeçare (5 vjeçare), si dhe politikave të miratuara nga Këshilli Bashkiak (rasti kur Këshilli Bashkiak ka vendosur një kufi limit të nivelit të të ardhurave p.sh. 30 - 40% e tyre do të shkojnë për investime kapitale), Bashkia do të arrijë të bëjë të mundur sigurimin e furnizimit me ujë të qytetit mbas 5 vjetësh.

Periudha e Planit të Investimeve Kapitale nënkupton numrin e viteve të parashikuara për investimet kapitale – pra në sa vite do të shtrihet plani i investimeve kapitale. Përgjithësisht, projektet e parashikuara të zbatohen gjatë vitit të parë apo të dytë, mund të vlerësohen lehtësisht përsa i përket qëllimit të tyre, kostove, shpenzimeve dhe fondit të disponueshëm. Përtej kësaj periudhe kohore bëhet veçanërisht i vështirë parashikimi i kostove dhe burimeve të financimit.

Të përfshish në planin e investimeve kapitale vetëm projektet të cilat parashikohet të realizohen vetëm gjatë vitit të ardhshëm, apo dy viteve në vazhdim, do të thotë të përjashtosh nga PIK projektet që zgjasin më tepër në kohë. Fokusi afatgjatë i detyron palët e përfshira në proces t'i kushtojnë vëmendje nevojave të ardhshme dhe jo vetëm emergjencave të momentit. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të konsiderojnë seriozisht planifikimin afatgjatë të investimeve nëse dëshirojnë të kenë akses në kreditë e tregut për të plotësuar nevojat e tyre për infrastruktura. Huadhënësit preferojnë të shohin një fokus afatgjatë, prandaj kjo bëhet një nga faktorët kryesorë në përcaktimin e mundësive të njësive vendore për të marrë kredi për qëllime të caktuara.

Në shumicën e proceseve për hartimin e PIK, katër apo pesë vjetë rezulton periudha më e favorshme e mbulimit. Viti i parë shërben si buxheti kapital i njësisë vendore, ndëra tre apo katër vitet e mbetura shërbejnë si vite të planifikuara. Në menyrë që të ruhet periudha që mbulohet nga PIK, ai duhet të përditësohet çdo vit duke shtuar një vit tjetër në fund të programit së bashku me listën e projekteve që pritet të nisë në atë vit.

Hartimi i kalendarit të PIK: Për të koordinuar detyrat dhe përgjegjësitë e ndryshme, kalendari i PIK duhet të përgatitet nga grupi lehtësues i PIK që në fillim të procesit. Kalendari është një instrument, i cili identifikon "kush bën çfarë dhe kur" gjatë gjithë procesit të hartimit të PIK. Kalendari shërben edhe për të udhëhequr të gjithë aktorët e përfshirë përgjatë procesit dhe u mundëson atyre informacionin në lidhje me afatet dhe miratimin.

Përfshirja e qytetarëve në procesin për hartimin e PIK: Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale i ofron qeverisjes vendore një mundësi më tepër për të përfshirë qytetarët në planifikimin dhe prioritarizimin e projekteve kapitale. Përfshirja e qytetarëve në këtë proces bëhet edhe me e domosdoshme në rastet kur njësitë vendore ende nuk kanë hartuar plane strategjike të zhvillimit dhe nuk kanë përcaktuar një listë projektesh strategjike për t'u zbatuar.

KAPITULLI III
IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE TË PIK

Është e rëndësishme të sqarojmë që në fillim se mbi ç'bazë bëhet klasifikimi i projekteve si të përshtatshme për t'u përfshirë në PIK dhe po ashtu cilat do të jenë kriteret të cilat do të përdoren më tej për prioritarizimin e tyre gjatë viteve.

Gjatë përgatitjes së projekteve për t'u perfshire në PIK merren në konsideratë si projektet e reja ashtu edhe projektet ekzistuese që mund të vazhdojnë të zbatohen gjatë viteve të PIK. Projektet mund të vijnë prej rivlerësimit të projekteve të Strategjisë së Zhvillimit të qytetit, si rezultat i diskutimeve me drejtuesit e rajoneve, si nevoja të brendshme të ngritura nga departamente të ndryshme të njësisë së qeverisjes vendore, si rezultat i proceseve të diskutimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, etj. Gjithësesi pas kësaj ato do të seleksionohen dhe vlerësohen prej grupit të punës/lehtësuesit të hartimit të PIK dhe më tej kalohet në prioritarizimin e tyre sipas kritereve të shpjeguara më poshtë.

Eksperienca e grumbulluar përgjatë këtyre viteve bashkëpunimi me njësitë vendore evidenton disa parime thelbësore të cilat mund të udhëheqin procesin e evidentimit dhe prioritarizimit të projekteve kapitale pjesë e PIK. Këto parime mbështesin qëllimin e hartimit të programeve dhe projekteve bazuar në:

- *Nevojat e komunitetit:* programet dhe projektet konsultohen me komunitetin dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces
- *Impaktin:* "të mirat materiale" të ofruara nga programet dhe projektet në lidhje me zhvillimin ekonomik, social dhe përfitime të tjera direkte/indirekte për komunitetin të afektuara nga projekti
- *Qëndrueshmërinë:* programet dhe projektet duhet të hartohen për të

garantuar brenda periudhave afat-mesme dhe afat-gjata përfitime në natyrë

- *Transparencën:* Transparenca e programeve dhe projekteve të cilat nënkupton mbikëqyrjen dhe kontrollin e tyre jo vetëm nga stafi Bashkisë por dhe komuniteti, përfituesit potencial, shoqëria civile, dhe donatorët duke mundësuar zgjerimin e bashkëpunimit dhe krijimin e përqasjeve të reja për bashkëfinancim
- *Parandalimin e dublikimeve:* Në përzgjedhjen e projekteve, për të eleminuar mbivendosjen e tyre nga të tjerë institucione. Bashkëpunimi ndërinstitucional në këtë rast është një instrument sa i dëshirueshëm aq edhe i nevojshëm.
- *Vlerësimin:* Identifikimi i objektivave dhe sistemi i vlerësimit të suksesit të programeve dhe projekteve
- *Pjesëmarrjen qytetare:* Programet dhe projektet do të inkurajojnë jo vetëm pjesëmarrjen por edhe kontributin e komunitetit
- *Zbatimin në nivel lokal:* Përqasja e krijuar do të inkurajojë sa më shumë të jetë e mundur zbatimin e projekteve të zhvillimit të menaxhuara jo vetëm nga njësitë vendore por edhe nga organizatat dhe agjencitë e tjera respektive si dhe do të lejojë shkëmbimin e eksperiencave dhe ndërtimin e kapaciteteve
- *Partneritetin:* Programet dhe projektet e planifikuara konsiderohen si një mundësi shumë e mirë për inkurajimin dhe zhvillimin e partneriteteve midis njësive vendore, komunitetit të biznesit dhe një rrjeti të gjerë stakeholderash prezentë
- *Monitorimin dhe matjen e rezultateve:* identifikon objektivat dhe vlerëson suksesin e programeve dhe projekteve
- *Praktikat më të mira:* të cilat evidentohen përgjatë hartimit dhe zbatimit të PIK
- *Kostot:* mirëpërcaktimi i tyre dhe përfshirja e tyre në buxhet i bën ato të kontrollueshme

- *Bashkëfinancimin:* programet dhe projektet do të lehtësojnë ardhjen e fondeve shtesë për bashkëfinancimin e projekteve të planifikuara si dhe do të inkurajojë zhvillimin e aktiviteteve të tjera në interes të komunitetit përtej qëllimit të PIK.

1.1 Hapat për evidentimin e projekteve kapitale në njësitë vendore

Rivlerësimi i projekteve të parashikuara në strategjinë e zhvillimit të qytetit. Një pjesë e mirë e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri kanë hartuar me ndihmën e donatorëve të huaj strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal, ose strategjitë e zhvillimit të qytetit. Plani i Investimeve Kapitale, si instrumenti bazë në zbatimin e këtyre strategjive, në një nga hapat më të rëndësishëm të tij, atë të identifikimit të projekteve kapitale, mundëson rivlerësimin e projekteve të parashikuara në strategji. Në këtë fazë analizohen të gjitha projektet e parashikuara si investime strategjike, duke i rivlerësuar ato në bazë të politikave dhe kritereve të PIK, rishikohen vlerat e këtyre projekteve dhe afatet kohore për zbatimin e tyre, dhe më tej bëhet prioritarizimi në bazë të kritereve që do të diskutojmë më tej.

Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës në qytet dhe nevojës së ardhshme për shërbime. Si hap i dytë në evidentimin e projekteve kapitale, stafi lokal i udhëhequr prej grupit të PIK duhet të vlerësojë gjendjen e infrastrukturave sipas përgjegjësive përkatëse. Për ta bërë sa më mirë këtë, iu nevojitet të dinë moshën, gjendjen, historinë e mirëmbajtjes dhe koston e zëvendësimit të tyre. Do të ishte shumë mirë nëse çdo departament nis të rregjistrojë gjendjen dhe cilësinë e infrastrukturave fizike përkatëse. Inventari kapital, sipas të cilit rregjistrohen ndërhyrjet për rikonstruksione në infrastrukturën fizike, mund të shërbejë më tej si një instrument me vlerë. Ky informacion do të shërbejë për të përcaktuar efektivitetin e ndërhyrjeve në kohë.

Vlerësimi i nevojave të tjera për investime kapitale si p.sh. projektet urbane apo zhvilluese: krijimi i zonave të gjelbra, strehimi social, krijimi i zonave të reja të parkimit, etj.

Rishikimi i projekteve të aprovuara më parë. Mund të ndodhë që projektet e aprovuara më parë të mos përfshihen në PIK për arsye sepse janë spostuar në listën e prioriteteve, kanë ndryshuar kushtet fizike në të cilat janë aprovuar, etj.

Përmbledhje për projektet e propozuara. Gjatë procesit të evidentimit të projekteve kapitale, grupi i PIK, mund të kërkojë që propozimet për projektet të bëhen mbi bazën e një formulari standard. Ky formular duhet të përfshijë: (i) titullin e projektit; (ii) përshkrimin dhe qëllimin e projektit; (iii) justifikimin për investimin; (iv) tabelën e aktiviteteve dhe afateve kryesore; (v) koston e ndërhyrjes dhe koston e mirëmbajtjes, etj. Veç kësaj, grupi i punës mund të kërkojë më tepër informacion për projektet e miratuara më parë.

Këto tabela sintetizojnë informacionin që i nevojitet grupit të PIK për fazat e tjera të hartimit të PIK. Për të siguruar se informacioni është i saktë dhe i qartë, grupi i PIK duhet të shpërndajë udhëzime të hollësishme për menyrën e plotësimit të tabelave.

Tabela 4.

Hapat për evidentimin e projekteve kapitale në njësitë e qeverisjes vendore:

- Rivlerësimi i projekteve të parashikuara në strategjinë e zhvillimit të qytetit
- Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës në qytet dhe nevojës së ardhshme për shërbime
- Vlerësimi i nevojave të tjera për investime kapitale si p.sh. projektet urbane apo zhvilluese
- Rishikimi i projekteve të aprovuara më parë
- Përmbledhje për projektet e propozuara

KAPITULLI IV
VLERËSIMI I AFTËSISË SË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE PËR TË FINANCUAR PIK

1.1 Mundësitë e financimit të investimeve kapitale

Në këtë kapitull janë paraqitur burimet e mundshme të financimit të investimeve kapitale dhe më tej është shtjelluar si mund të bëhet analiza dhe shpërndarja e fondeve për projektet kapitale në kuadër te PIK .

Fondet e disponueshme të njësisë vendore për investime kapitale rezultojnë nga:



- *Të ardhurat lokale kapitale: Këtu futen të ardhurat të cilat vijnë vetëm një herë dhe krijohen p.sh. nga shitja e një ndërtese në pronësi të Bashkisë, ndërtesë e cila nuk nevojitet për përdorim publik. Po kështu mund të futen edhe të ardhurat që krijohen nga dhënia me qera e një objekti apo aseti të vet me qëllim përdorimin për interesa publike.*
- *Mbetja operative e planifikuar: Është teprica neto operative e cila del si diference midis te ardhurave operative dhe shpenzimeve operative të bashkisë*
- *Përdorimi i fondit rezervë kapital: Ndonëse njësitë vendore në Shqipëri ende nuk kanë nisur të krijojnë një fond rezervë kapital për zëvendësimin e pajisjeve kapitale apo për investime kapitale, kjo përbën një nga mundësitë potenciale në të ardhmen.*

- Përdorimi i huasë: Së fundmi është miratuar nga parlamenti ligji për huamarrjen vendore i cili u krijon njësive të qeverisjes vendore mundësinë dhe hapësirat e nevojshme ligjore për marrjen dhe përdorimin e huasë qoftë afatshkurtër (në rast mungese likuiditetesh) apo edhe afatgjatë (për investime kapitale). Duhet patur parasysh se, në këtë rast pagesat vjetore të huasë do të ishin prioriteti kryesor i bashkisë në përdorimin e mbetjes operative para se fondet të alokohen për investime të tjera kapitale apo fond rezervë.
- *Transfertat nga qeveria qëndrore: Këtu parashikohen transfertat nga qeveria qëndrore, të cilat vijnë në formën e grantit të kushtëzuar për investime, në formën e grantit të pakushtëzuar i cili mund të përdoret për investime kapitale dhe në formën e granteve konkurruese ose të ashtuquajturat "fondet për zhvillimin e rajoneve".*
- *Grante nga donatorët: Këtu futen të gjitha të ardhurat për të cilat bashkia ka siguri se do i vijnë nga donatorët duke identifikuar qarte donatorin, fondin, kërkesat e tij dhe vitin.*
- *Forma të Partneritetit Publik - Privat: Sektori privat ofron burime të reja kapitale duke çliruar të ardhurat e njësive vendore dhe mundësuar përdorimin e tyre për financimin e objektivave të tjerë të njësisë*

1.2 Partneriteti Publik – Privat si një nga format kryesore të financimit të Investimeve Kapitale

Vitet e fundit njësitë vendore po shprehin interes gjithnjë në rritje për gjetjen e instrumentave të tjerë potencialë të financimit të kostove të projekteve kapitale të parashikuara në PIK. Partneritetet Publik - Privat vlerësohen si instrumenta efektivë përsakohë ato mobilizojnë burime

financiare jashtë buxheteve vendore në realizimin e prioriteteve të njësisë. Këto forma bashkëpunimi jo vetëm çlirojnë buxhetin vendor nga kostot kapitale, por ato përmirësojnë efiçencën duke zgjeruar gamën e shërbimeve dhe sjellin pranë komunitetit shërbime cilësore të nxitura nga konkurenca.

Kjo skemë e financimit të projekteve kapitale ofron avantazhet si më poshtë:

- Sektori privat ofron burime të reja kapitale duke çliruar të ardhurat e njësive vendore dhe mundësuar përdorimin e tyre për financimin e objektivave të tjerë të njësisë. Angazhimi i burimeve të reja kapitale nga sektori privat do të thotë të transferosh të gjithë riskun/rrezikun e lidhur me projektet te sektori privat ose te individët.
- Partneriteti publik – privat i mundëson sektorit publik të tërheqë ekspertizën dhe aftësitë e sektorit privat në minimizimin e kostove.
- Përfshirja e sektorit privat mund të udhëheqë më shumë veprime inovative dhe eficiente në raport me ofrimin e shërbimeve nga sektori publik.
- Sjell më pranë njëri – tjetrit njësitë vendore, komunitetin dhe biznesin

1.3 Analiza e mundësive të financimit

Në fillim të çdo viti buxhetor, është e domosdoshme që Bashkia të hartojë politikat që do të udhëheqin përgatitjen në atë vit të PIK dhe buxhetin vjetor kapital. Këto politika, do të konsultohen me departamentet dhe drejtoritë e Bashkisë dhe ndërmarrjet në varësi të saj, të cilat përgatisin kërkesat e tyre për investime kapitale, siç mund të jenë arsimi (sistemi parashkollor), shërbimet publike, mirëmbajtje rrugë trotuare, ujësjellës kanalizime, etj. Disa politika të cilat mund të merren në konsideratë janë si më poshtë:

- Miratimi i një përqindjeje të caktuar për investimet kapitale të burimeve të veta dhe të ardhurave nga Granti i Pakushtëzuar. Të ardhurat (të ardhurat kapitale) në këtë rast duhet të parashikohen të paktën për aq vjet sa dhe është parashikuar PIK.
- Rishikimi i kritereve të vlerësimit të projekteve për pasqyrimin e ndryshimeve, sipas kushteve aktuale dhe prioriteteve në vazhdimësi (rishikimi i projekteve në çdo vit). Siç kemi përmendur edhe më tej, këto kritere mund të ndryshojnë nga viti në vit sipas kushteve specifike të njësisë apo edhe sipas situatave financiare.

Procesi më tej vazhdon me analizimin e opsioneve që ndikojnë në financimin e PIK, së pari duhet patur parasysh mundësia që projektet e financuara dhe të zbatuara kanë për të gjeneruar të ardhura nëpërmjet tarifave të ndryshme të vendosura për shërbimet në dispozicion të të cilave këto projekte hartohen. P.sh. një projekt që lidhet me furnizimin e një zone me ujë të pijshëm na sjell të ardhura si rezultat i grumbullimit të tarifës së furnizimit me ujë menjëherë pas zbatimit të projektit. Disa projekte mund të jenë edhe totalisht të vetë-financuar, do të thotë se shpenzimet për to gjenerohen shumë shpjet me përfundimin e projektit. Disa të tjerë mund të jenë vetëm pjesërisht të vetë-financuar. Do të thotë që edhe pas zbatimit të projektit dhe vënies në perdorim, kostot e tij do të mbulohen pjesërisht. Në përgatitjen e një analize financiare të projektit është e rëndësishme që të konsiderohen veç të tjerash edhe elementët e mëposhtëm:

a. Është e rendësishme të garantohet se janë bërë llogaritjet e sakta të kostove të një projekti, por në të njëjtën kohë të kostove që do të nevojiten për përdorimin dhe mirëmbajtjen në përfundim të projektit. Në rast se ekziston më tepër se një

propozim teknik (p.sh. riparim kapital kundrejt zëvendësimit), duhen konsideruar me kujdes të dy opsionet në funksion të fizibilitetit financiar të projektit. Po ashtu, brenda mundësive teknike duhet përcaktuar nëse madhësia e projektit është në konsistencë me nevojat dhe kërkesat. Një projekt i mbi-dimensionuar mund të mos jetë i mundur, por po të ripunohet sipas nevojave reale mund të kthehet në të përballueshëm.

b. Duhet analizuar me kujdes sa mund të përftohet nga tarifat dhe taksat e shërbimit të ofruara nga projekti pasi të ketë përfunduar zbatimi i tij dhe të jetë vënë në funksionim. Duhet patur kujdes që të mos parashikohet se do të vendosen apriori tarifa të tilla që thjeshtë të garantojnë përftimin e vlerës së investimit. Duhet konsideruar se çfarë impakti mund të ketë investimi në rritjen e tarifave dhe detyrimeve për qytetarët dhe në të njëjtën kohë duhet konsideruar se jo të gjithë do jenë në gjendje/do të dëshirojnë të paguajnë në kohë.
c. Duhet parë mundësia për të kursyer prej kostove operative apo të mirëmbajtjes së njësisë së qeverisjes vendore. Pjesa që mund të kursehet prej ketyre shpenzimeve mund të përdoret për te mbuluar të paktën kostot për hartimin e projekteve kapitale.

Pasi janë përcaktuar se cilat projekte mund të financohen pjesërisht, apo totalisht, nëpërmjet vetë-financimit, apo prej qeverisë qëndrore, ose programeve të donatorëve, hapi tjetër lidhet me evidentimin e fondit lokal të disponueshem për investime kapitale. Në këtë rast duhet konsideruar mundësia e huamarrjes. Gjatë përgatitjes së analizës për kacitetin e huamarrjes duhet mbajtur parasysh sa më poshtë:

a. E shprehur në formën e saj më të thjeshtë, kapaciteti i huamarrjes së njësisë vendore përcaktohet nga sa fonde mundet njësia të

lerë mënjanë prej të ardhurave aktuale të saj në çdo vit, për vitet që pasojnë, në mënyrë që të përballojë pagesën vjetore të kredisë/borxhit. Kjo pagesë mund të mbulohet nga të ardhurat e siguruara prej taksave lokale dhe buxhetit të pakushtëzuar. Detaje në lidhje me këtë përcaktohen në ligjin për huamarrjen vendore të sapomiratuar nga parlamenti.

b. Kapaciteti për përballimin e huasë/borxhit ndikohet prej vullnetit dhe aftësisë së njësise vendore për të limituar shërbimet e drejtpërdrejta në funksion të komunitetit në mënyrë që të përballojë investimet kapitale dhe kreditë për të përballuar këto investime. Duhet mbajtur parasysh se plan pagesat për borxhin vjetor llogariten prej të ardhurave, të cilat po ashtu përdoren për shërbimet e ofruara komunitetit si mirëmbajtja e rrugeve, shkollave, hapësirave të gjelbra, etj. Po kështu, janë po këto të ardhura nëpërmjet të cilave mbulohen kostot administrative, siç janë p.sh. rrogat e punonjësve të njësisë vendore.
c. Kapaciteti për përballimin e huasë ndikohet gjithashtu nga vullneti dhe aftësia e njësisë vendore për të pranuar kostot dhe risqet që lidhen me borxhin/kredinë.
d. Legjislacioni aktual “Për huamarrjen e njësive të qeverisjes vendore” përcakton tre kritere bazë të lidhura me huanë afatgjatë dhe konkretisht:
    i. Pagesat për shërbimin vjetor të huasë afatgjatë (shërbimi i borxhit) nuk mund të tejkalojnë 20% të mesatares aritmetike të të ardhurave gjithsej nga taksat e tarifat vendore, taksat e ndara dhe transferta e pakushtëzuar në tre vitet fiskale paraardhëse të vitit në të cilin parashikohet të merret hua
    ii. Raporti i tepricës operative të vitit fiskal paraardhës

me shërbimin e borxhit që duhet të paguhet çdo vit për borxhin afatgjatë të jetë jo më pak se 1,4:1

iii. raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave operative nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transferta e pakushtëzuar të jetë jo më shumë se 1,3:1

1.4 Analiza e historikut financiar të njësisë vendore

Kjo analize rezulton veçanërisht e nevojshme në kushtet kur njësia e qeverisjes vendore është duke hartuar për herë të parë Planin e Investimeve Kapitale. Për këtë arsye, njësisë i duhet të parashikojë qartë të ardhurat dhe mundësitë për të përballuar investime. Në ndihmë të ketij parashikimi sa më të saktë vjenë analiza e historikut fianciar të njësisë vendore. Kjo analizë nuk është gjë tjetër veçse një reflektim në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e njësisë vendore gjatë 3 – 5 vjetët e fundit, mbi bazën e të cilit sintetizohen e përgjithësohen tendencat që hasen në lidhje me tepricën operative të njesisë. Kjo tendencë do të përbëjë një ndër faktorët kryesorë, që së bashku me rritjen ekonomike të vendit do të ndikojnë në parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë vendore.

Gjithashtu, analiza financiare do të bëjë të mundur identifikimin e burimeve financiare të nevojshme që Bashkia do të ketë disponibël në funksion të financimit të investimeve kapitale në vite. Këto burime do të llogariten mbasi të jenë identifikuar të ardhurat operative dhe shpenzimet operative. Por, ky është vetëm njëri prej burimeve pasi fondet në dispozicion të investimeve kapitale vijnë edhe nga të ardhurat vendore kapitale (shitja e një prone/aseti pra, të ardhurat që krijohen vetëm një herë dhe që nuk përsëriten nga viti në vit siç ndodh me të ardhurat e tjera të sigurta të Bashkisë), nga qeveria qëndrore në formën e granteve, nga donatorët dhe një tjetër burim është dhe huaja. Kjo analizë rekomandohet të bëhet në fillim të vitit buxhetor me qëllim që njësia të ketë kohën e

mjaftueshme në dispozicion për të bërë të mundur rishikimin e buxhetit, kërkesave, nevojave, rishpërndarjen e burimeve financiare, përballimin e situatave të ndryshme me të cilat mund të ballafaqohet në një vit të caktuar buxhetor.

Në mënyrë të përmbledhur kemi paraqitur skemën e financimit të investimeve kapitale si në figurën 1.

Figura 2. Skema e financimit të investimeve kapitale




Figura 1. Skema e financimit të investimeve kapitale

1.5 Llogaritja Analitike e të ardhurave të njësisë vendore

Më poshtë shpjegohet mënyra sesi mund të llogariten burimet e të ardhurave që njësia vendore parashikon të ketë në dispozicion nga Taksat e Tarifat Vendore, por edhe pjesë të të ardhurave nacionale që me ligj i takojnë njësisë për çdo vit dhe që janë të ardhura të sigurta dhe të vazhdueshme të saj.

Parashikimi i mbetjes operative për investime: Tabela e parashikimit të mbetjes operative për investime ndahet në tre seksione:

a. Seksioni A — Të ardhurat operative
b. Seksioni B — Shpenzimet operative
c. Seksioni C — Mbetja e planifikuar operative

Duke qenë se PIK bën të mundur planifikimin dhe mënyrën e realizimit/ financimit të Investimeve Kapitale në vite është e domosdoshme që parashikimi i mbetjes operative të n të bëhet për disa vite (2009–2012). Kjo bëhet vetëm nëse Bashkia evidenton saktë të ardhurat operative dhe shpenzimet operative për vitet në vijim. Përllogaritja e "mbetjes operative për investime" në vite bën të mundur vazhdimësinë dhe monitorimin e rezultateve të PIK, por edhe të situatës ekonomiko - financiare të njësisë me qëllim mbështetjen e PIK me burimet financiare të kërkuara.

Duke ditur vlerën/koston e projektit dhe mbetjen operative të njësisë për vitet e ardhshme është lehtësisht e mundur të planifikohet edhe mënyra e financimit të Investimeve Kapitale në vite si dhe të ndara veç e veç ku për çdo vit evidentohet investimi kapital i parashikuar, kostoja e tij dhe periudha e financimit për çdo investim të planifikuar.

a. Seksioni A - Të ardhurat operative

Në këtë seksion do të përfshihen të ardhurat nga Taksat, Tarifat Vendore, Granti i Pakushtëzuar dhe të ardhurat nga Taksat e ndara. Për sa i përket Taksave dhe Tarifave Vendore sjellim në vëmendje se legjislacioni aktual

i jep njësisë autoritet të plotë për planifikimin dhe menaxhimin e tyre.

b. Seksioni B - Shpenzimet operative

Në këtë seksion do të futen të gjitha shpenzimet që bën Bashkia pa përfshirë shpenzimet për investime kapitale. Në këto shpenzime do të futen shpenzimet në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore, shpenzimet operative e të mirëmbajtjes, ndihma ekonomike dhe paaftësia, subvencionet, etj. të ngjashme me to. Në shpenzimet operative do të futen edhe të gjitha shpenzimet që bën njësia për shërbimet publike, përgjegjësi e vet njësisë, si shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, gjelbërimit, ndriçimit, dekorit, funeralit, mirëmbajtjes së rrugë - trotuareve pa lënë mënjanë edhe fondin rezervë.

c. Seksioni C - Mbetja operative e planifikuar

Mbetja operative e planifikuar është diferenca midis të ardhurave operative dhe shpenzimeve operative. Kjo mbetje është shuma e parave që njësia do të ketë në dispozicion gjatë vitit buxhetor për investime kapitale. Pavarësisht kësaj, ligji i ri i huamarrjes i jep të drejtë Bashkisë të marrë hua për të financuar investime kapitale. (për investime kapitale përdoret huaja afatgjatë)

Mbetja Operative e Planifikuar, e cila asnjëherë nuk duhet të llogaritet para se njësia të sigurojë fonde (burime financiare) të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve operative, në rastin kur Bashkia ka marrë hua për një ose disa investime kapitale, atëherë pagesat për huanë përbëjnë shpenzimin e parë që planifikohet. Më tej shuma që ngelet për përdorim do të vihet në dispozicion për investime të tjera kapitale.


1.6 Plani i Investimeve Kapitale dhe Programi Buxhetor Afatmesëm

Kuadri ligjor për buxhetin vendor sjell një tjetër përqasje të burimeve financiare në periudhën afatmesme. Programi Buxhetor Afatmesëm

(PBA) sjell akoma më pranë njëri - tjetrit burimet financiare me prioritetet e parashikuara në PIK. Skema e re e menaxhimit të burimeve financiare lidhet me strukturimin e tyre jo mbi bazë funksionesh por mbi bazë programesh brenda të cilëve mund të përfshihen më shumë se një funksion i njësisë së qeverisjes vendore. Në këtë aspekt, hartimi i PIK, parashikimi i projekteve prioritare kërkon domosdoshmërit një parashikim real të të ardhurave dhe shpenzimeve në vitet që vijnë e këtu gjenden pikat e përbashkëta midis PIK dhe PBA –së ku burimet financiare vihen në dispozicion të projekteve të kërkuara dhe të planifikuara (aneksi 10). Pasqyrimi i treguesve ekonomiko – financiar dhe projeksioni i tyre në vite krijojnë një kuptim më të qartë mbi lidhjen organike të Planit të Investimeve Kapitale të Bashkisë me burimet financiare në dispozicion nga të gjitha burimet e mundëshme të financimit. Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Plani Investimeve Kapitale stimulojnë planifikim të kujdesshëm dhe shumë afër realitetit të burimeve financiare Bashkisë për vitet që vijnë duke plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar nëpërmjet përcaktimit të politikave dhe programeve për çdo aktivitet dhe identifikimit të kostove respektive brenda limitit të burimeve disponibël në periudhën afatmesme. Për më tepër ato sjellin në vëmendjen e stafeve lokale nevojën për identifikimin e indikatorëve të performancës fokusuar në inpute, outpute dhe outcome.

Skema më poshtë paraqet lidhjen midis PIK dhe Buxhetit Afatmesëm ku të dy komponentët synojnë realizimin e outputeve të lidhura me programet respektive.

Figura 3. Skema e financimit të investimeve kapitale



Skema më sipër paraqet lidhjen e buxhetit afatmesëm me PIK, sipas së cilës inputet (burimet) ndahen mbi bazë programi dhe aktivitetet përmbushin "objektivat e programit" duke garantuar outputet e planifikuara. Ajo çka synohet nëpërmjet këtyre dy komponentëve lidhet me një përqasje të re të Buxhetit vendor duke orientuar përdorimin e burimeve financiare jo sipas artikujve (line – item budget) por sipas arritjes së objektivave brenda programeve respektive (program budget) për vlerësimin e performancës bazuar në indikatorë të lidhur me inputet, outputet dhe outcomet. Aneksi 10 zhvillon projektet kapitale brenda programit respektiv duke krijuar lidhjen midis PIK dhe PBA.

Përveç anëve të përbashkëta, PIK dhe PBA, kanë edhe edhe diferenca. Ndërsa PBA përmban parashikimin për tre vjet të të ardhurave të veta, PIK përmban edhe të ardhura të tjera si nga huaja, grantet konkuruese etj. Si rrjedhojë, në PBA planifikohen vetëm një pjesë e projekteve kapitale të përfshira në PIK.

KAPITULLI V
INVESTIMET KAPITALE DHE KRITERET PËR PRIORITARIZIMIN E TYRE

Në kapitullin III diskutuam për mënyrën e evidentimit të projekteve kapitale. Ky proces pasohet prej prioritarizimit të tyre mbi bazën e kritereve të përcaktuara qartë. Kjo pjesë e materialit shpjegon metodologjinë, e cila do të udhëheqë vendimmarrësit në njesitë vendore në përzgjedhjen e projekteve që ata dëshirojnë të përfshijnë si prioritete në PIK brenda limiteve të fondit të disponueshëm. Kjo nënkupton se në përgjithësi fondi në dispozicion është më pak se nevojat e evidentuara prej njësive të qeverisjes vendore për projekte kapitale. Drejtuesit lokal duhet të zgjedhin mes një numri të madh projektesh të mundshme, të gjithë me nevojën për t'u financuar. Projektet kapitale mund të mbështesin qëllime të ndryshme të komunitetit dhe brenda këtij komuniteti, nevoja të ndryshme. Drejtuesit lokal duhet të shoshitin këto projekte dhe të përzgjedhin prej tyre vetëm ato, të cilat mund t'i financojnë dhe zbatojnë, e në të njëjtën kohë të sigurojnë një shpërndarje të balancuar të plotësimit të nevojave të komunitetit. Për të gjitha këto arsye, grupi lehtësues i PIK ka një rol shumë të rëndësishëm, dhe ndërkohë, duhet të marrë përgjegjësi konkrete për përgatitjen e një sërë kërkesash dhe kriteresh të cilat duhet të plotësojë një investim i parashikuar për t'u klasifikuar si investim kapital.

1.1 Metodologjia per prioritarizimin e projekteve kapitale

Ka disa elementë sipas të cilave mund të bëhet prioritarizimi i një projekti kapital, por që procesi të rezultojë lehtësisht i kuptueshëm për të gjithë, mund të përdoren elementët si më poshtë:

- Vlerësimi mbi bazë kriteresh
- Vlerësimi me pikë

Vlerësimi mbi bazë kriteresh: Për të bërë këtë vlerësim, njësia e qeverisjes vendore përcakton një listë kriteresh, të cilat do të shërbejnë në përzgjedhjen ose jo të projekteve kapitale. Vlerësohen si projekte të përshtatshme për t'u përfshirë në PIK ato të cilat plotësojnë më tepër nga kriteret e aprovuara.
Mbi bazën e kritereve të përmbushura nga projekti, bëhet edhe renditja e tyre në Planin e Investimeve Kapitale dhe njëkohësisht, pas përcaktimit të kësaj renditjeje, bëhet edhe ndarja/grupimi i investimeve sipas sektorëve/programeve përkatës.
Në përcaktimin e kritereve për prioritarizimin e projekteve të PIK nuk ka një limit përsa i përket numrit të tyre. Po kështu, proçesi mbetet fleksibël dhe kriteret mund të ndryshojnë nga viti në vit, sipas situatave dhe prioriteteve të njësisë vendore.

Vlerësimi me pikë: Për të lehtësuar edhe më tej proçesin e prioritarizimit të projekteve të PIK, vlerësimi mbi bazë kriteresh shoqërohet edhe me vlerësimin me pikë. Sipas kësaj mënyre vlerësimi, për çdo kriter të propozuar vendoset një sasi pikësh në dispozicion (p.sh. nga 1 në 5, ku me 1 vlerësohet kriteri që plotësohet më keq dhe me 5, ai që plotësohet më mirë). Në përfundim, vlerësimi për projektin e propozuar bëhet mbi bazën e pikëve totale që ai grumbullon sipas vlerësimit të kriterit dhe atij me pikë. Renditja përfundimate e projekteve kapitale bëhet mbi bazën e pikëve totale që projekti ka arritur të grumbullojë. Në përfundim të këtij proçesi projektet grupohen sipas sektorëve.

Në anekset bashkangjitur jepen shembuj të ngjashëm sipas të cilëve bëhet vlerësimi më pikë i projekteve nisur nga kriteret që ata plotësojnë. Në njërin nga shembujt përdoren njëmbëdhjetë kritere (sociale, ekonomike, financiare, shëndeti publik, siguria, etj.) për vlerësimin e prioritetit relativ të secilit prej projekteve të përfshira në PIK. Për secilin prej këtyre njëmbëdhjetë faktorëve janë vendosur pikët maksimale të mundshme të cilat i jepen projektit kur e përmbush plotësisht kriterin në fjalë. Numri i pikëve të shpërndara në secilin prej kritereve shpreh edhe rendësinë që secili prej tyre ka në totalin e përgjithshëm të vlerësimit të projektit (disa kritere janë vlerësuar me 0-5 pikë, ndërkohë që kritere të tjera janë vlerësuar me 0-10 pikë) Në fund të këtij proçesi listohen rezultatet totale për çdo projekt. Në rastin e shpjeguar, vlerësimi total për një projekt do ishte 70 pikë. Kjo tabelë është indikative, ajo është vetëm një shembull për të treguar se si mund të operohet për prioritarizimin e projekteve. I takon vendimmarrësve në njësitë e qeverisjes vendore të përcaktojnë se cilat janë kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i projekteve dhe si do të bëhet shpërndarja e pikëve për secilin prej kritereve në varësi të rëndësisë së tyre.

1.2 Investimet Kapitale dhe cikli i projektit

Një projekt është "një seri aktivitetesh specifike me qëllim vlerësimin e objektivave specifik brenda periudhës së caktuar me një buxhet të caktuar"[1]. "Cikli i projektit" është mënyra e duhur për të identifikuar elementët kryesorë të përbashkët të projekteve, dhe si ata lidhen me njëri – tjetrin. Skema e paraqitur tregon fazat kryesore të "zhvillimit të projektit" mbi të cilat kornizohen kriteret e prioritarizimit të tyre.

[1] *Burimi EC. Manual: Cikli i Menaxhimit të Projektit*

Programimi: Përcaktimi i udhëzimeve të përgjithëshme dhe parimeve për bashkëpunim dhe evidentimin e fushave dhe programeve kryesore në të cilat do të fokusohen politikat e financimeve kapitale (ide për projekte kapitale brenda programeve respektive).

Identifikimi: Kjo fazë e ciklit të projektit shërben për të identifikuar se ku do të duhet të fokusohen projektet, duke na mundësuar të identifikojmë se kush do të përfitojë dhe cilat janë nevojat e tyre. Vlerësimi i nevojave do të japë një përshkrim të problemeve të komunitetit, ndërkohë që vlerësimi i kapaciteteve do të ndihmojë në identifikimin e problemeve të cilat projekti do të duhet të adresojë. Kjo fazë shënon edhe fillimin e punës për përcaktimin e indikatorëve të performancës së projektit të cilët do të shërbejnë për matjen e impaktit të tyre brenda programit ku bëjnë pjesë.

Përgatitja: Të gjitha aspektet e rëndësishme të projekteve janë studiuar, duke marrë në konsideratë pikëpamjet e stakeholderave në lidhje me problemet. Përgjatë kësaj faze përcaktohen aktivitetet specifike për zbatimin e projektit dhe llogariten inputet e nevojshme për zbatimin e tyre. Duke përcaktuar saktë aktivitetet si dhe inputet në dispozicion shmangen faktorët të cilët mund të riskojnë realizimin e outputit të dëshiruar.

Financimi: Kjo fazë e ciklit të projektit ndihmon në alokimin e kostove të projekteve si dhe përcaktimin e sasisë së mjeteve financiare të cilat do të përdoren për financimin e projekteve brenda secilit program. Në këtë fazë vendoset se cilat do të jenë projektet që do të financohen dhe sa do të jetë niveli i financimit të tyre.

Zbatimi: Kjo fazë fillon me tenderimin e projektit dhe shtrihet përgjatë gjithë periudhës në të cilën projekti do të zbatohet. Burimet financiare të miratuara përdoren për garantimin e aktiviteteve të planifikuara dhe arritjen e objektivave, progresi të cilave sigurohet nëpërmjet supervizimit dhe monitorimit.

Vlerësimi: Kjo fazë lidhet me vlerësimin dhe kontrollin e impaktit të projektit, përmbushjes së objektivave, efiçencës, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë. Kjo fazë realizohet pas përfundimit të projektit dhe konkluzionet merren në konsideratë gjatë zbatimit të projekteve të tjera të ngjashme.

1.3 Investimet Kapitale dhe analiza kosto – përfitim

Analiza kosto – përfitim[2] është një instrument financiar i cili përdoret për të ndërmarrë vlerësime ekonomike të projekteve të propozuara në PIK. Ajo ndihmon në vlerësimin e alternativave të investimit duke synuar përdorimin e alternativës më të mirë, më ekonomike. Të gjitha vlerësimet do të bëhen duke marrë për nivel krahasimi alternativën "nuk investohet" dhe "investim minimal". Kostot dhe përfitimet e një investimi janë kostot reale ekonomike të cilat përfshijnë kostot direkte, indirekte dhe shpenzimet e përgjithshme. Mbi bazën e këtyre llogaritjeve vendimmarrësit mund të krahasojnë treguesit për të përzgjedhur alternativën më të mirë të mundshme për investimin e parashikuar. Ndonëse në praktikë shumica e kostove dhe përfitimeve mund të maten (*kostot relevante*), matja e tyre për të gjithë projektet në disa raste mund të jetë e pamundur. Legjislacioni i hartimit të buxhetit afatmesëm zhvillon analizën kosto/përfitim bazuar në kostot marxhinale e cila do të llogaritet si diferencë e kostos së plotë

[2] *Kjo analizë është parashikuar si element i vlerësimit të projekteve kapitale gjatë hartimit të buxhetit afatmesëm*

zbritur vlerën e alternativës "nuk investohet". Shpeshherë ka projekte kostot e të cilëve nuk mund të vlerësohen në terma monetarë e në këtë rast duhet të vlerësohen nga pikëpamja e përfitimit të publikut dhe institucionit përgjegjës. Analiza kosto – përfitim ndërmerret përsakohë vlerësohet jeta e dobishme e investimit kapital (zakonisht 20 vjet), por, edhe përtej këtij limiti investimi kapital ka një "*vlerë të mbetur*" e cila do të merret në konsideratë në kalkulimet e kostove pavarësisht faktit se mund të jetë edhe e vështirë ndërkohë që edhe amortizimi nuk do të jetë element i llogaritjes së kostos financiare por i shtohet "vlerës së mbetur" e cila shtohet në llogaritjen e kostove të alternativave të investimit.

Vlerësimi përfitimeve ka për qëllim të tregojë nëse të mirat dhe produktet e realizuara justifikojnë kostot për prodhimin e tyre. Për të vlerësuar krahasimin e alternativave të investimit dhe diferencave midis tyre është shumë e rëndësishme që edhe përfitimet të shprehen në terma financiar (përjashtim rasteve kur ky vlerësim është i pamundur).

Parimet e analizës kosto/përfitim zhvillohen bazuar në disa elementë shumë të rëndësishëm dhe konkretisht:

- *Identifikimi i projektit* – Vlerësohet si hapi i parë në zhvillimin e analizës kosto/përfitim dhe përfshin:
    - Përcaktimin e problemit
    - Shpjegimin e tij
    - Identifikimin e objektivave strategjikë
    - Diskutimin me stakeholderat
    - Shtrirjen e projektit (koha, lidhja e tij me projekte të tjera, fazat e realizimit, përcaktimin e kostove indikative)
- *Specifikimet e opsioneve të realizimit të projektit* – natyra e opsioneve të vlefshme mund të variojë në varësi të natyrës së problemit që adreson.

- *Përcaktimi i alternativave bazë* - Në kontekstin e PBA-së vlerësohen tre alternativa bazë të vlerësimit të rezultateve dhe objektivave të investimit: a) nuk investohet; b) investim minimal dhe c) investim i konsiderueshëm.
- *Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve sasiore dhe cilësore* – kostot dhe përfitimet të cilat mund të shprehen drejtpërdrejt në terma financiarë njihen si kosto/përfitime të matshme dhe kostot/përfitimet të cilat nuk mund të shprehen në terma financiarë njihen si kosto/përfitime cilësore (jo të matshme në terma financiarë)
- *Vlera aktuale dhe skontimi* - Në shumicën e projekteve, analiza kosto/përfitim shtrihet në një kohë të caktuar e për këtë është e rëndësishme të llogaritet vlerën aktuale të të gjitha kostove dhe përfitimeve. Ky term bazohet në parimin se njerëzit preferojnë të kenë të mirat dhe përfitimet sa më shpejt të jetë e mundur dhe ndërkohë të shtyjnë pagesat për kostot sa më shumë të jetë e mundur. Standardi për vlerësimin e kostove dhe përfitimeve në periudha të ndryshme bazohet në faktin se një shumë e caktuar mjetesh monetare sot nuk ka të njëjtën vlerë në një kohë tjetër. Kjo përqasje krahason fluksin në kohë të kostove dhe përfitimeve në periudha të ndryshme. Norma e skontimit përdoret për shndërrimin e kostove dhe përfitimeve të ardhshme në një vlerë të vetme e cila quhet "vlera aktuale" duke mundësuar krahasimin e tyre. Vlera aktuale e kostos dhe përfitimit mund të shprehet si më poshtë[3]:

$$PV_{Costs} = \sum_{n=0}^{N} \frac{C_n}{(1+r)^n}$$

$$PV_{Benefits} = \sum_{n=0}^{N} \frac{B_n}{(1+r)^n}$$

[3] *Cost benefit analysis methodology*

ku:

PV = vlera aktuale (e tanishme)

Cn = koston në vitin ***n*** e shprehur në lek

Bn = përfitimet në vitin ***n*** shprehur në lek

r = norma reale e skontimit

n = periudha e vlerësimit në vite

- *Vlerësimi i inflacionit dhe normës së interesit* – është e rëndësishme se inflacioni nuk shtrembëron kostot dhe përfitimet. Inflacioni nuk rrit vlerën reale të kostove dhe përfitimeve; vetëm se ai rrit vlerën e mjeteve monetare për arritjen e tyre. Llogaritja e interesave nuk merret në konsideratë përgjatë vlerësimit pasi padyshim ato janë reflektuar në procesin e skontimit.
- *Vlera aktuale neto* – është ndoshta njësia matëse e drejtpërdrejtë e analizës kosto/përfitim. Ajo mund të shprehet sipas formulës më poshtë:

$$NPV = \sum_{n=0}^{N} \frac{B_n - C_n}{(1+r)^n}$$

ku:

NPV = vlera aktuale neto (VAN)

Bn = përfitimet në vitin n shprehur në lek

Cn = kostot në vitin n shrehur në lek

r = norma reale e skontimit

n = periudha e vlerësimin në vite

Tabela 5.

Nqs	Kuptimi	Veprimi
NPV > 0	Projekti është i vlefshëm	Projekti do të pranohet për t'u zbatuar
NPV < 0	Projekti nuk është i vlefshëm	Projekti duhet të refuzohet
NPV = 0	Projekti as shton as pakëson vlerën	Projekti mund të pranohet nqs norma e kërkuar e kthimit është përcaktuar

- *Norma e brendshme e kthimit* – është norma e skontimit në të cilën vlera aktuale neto është e barabartë me zero. Një projekt është potencialisht i vlefshëm nëse norma e brendshme e kthimit është më e madhe se norma e skontimit e aplikuar në vlerësim. Sa më e lartë të jetë norma e brendshme e kthimit aq më i preferueshëm është projekti
- *menaxhimi i riskut dhe ndryshimeve* – është një tjetër komponent i cili duhet marrë në konsideratë përgjatë vlerësimit të alternativës më të mirë të investimit

1.4 Kriteret për përzgjedhjen e projekteve prioritare në PIK

Më poshtë ju sjellim disa nga kriteret bazë, të cilat mund të përdoren nga njësia e qeverisjes vendore, për klasifikimin dhe prioritarizimin e projekteve kapitale të PIK. Këto kritere nuk janë të detyrueshme, ato mund të variojnë sipas njësive vendore dhe nevojave të tyre. Megjithatë përcaktimi i këtyre kritereve lhtëson punën e grupit të PIK dhe shërben si bazë në zbatimin e mëtejshëm të procesit. E rëndësishme është që të gjitha kriteret e vendosura të marrin në konsideratë tre elementë kryesorë:

a. koston minimale të investimit
b. jetëgjatësinë minimale të përdorshme të investimit
c. kostot e mirëmbajtjes

Në funksion të këtyre tre treguesve thelbësorë mund të specifikohen më tej disa prej kritereve si më poshtë:

i. Projekti ka natyrë urgjente (p.sh. nëse rrezikohet jeta e banorëve të një blloku të caktuar, rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës i ujit të pijshëm do të shmangë epideminë në këtë lagje/bllok, etj.)

ii. Projektet, realizimi i të cilëve kushton mbi një vlerë, të përcaktuar nga grupi i PIK dhe njësia vendore.
iii. Zbatimi i projektit gjeneron të ardhura në buxhetin e njësisë vendore dhe këto të ardhura brenda një periudhe prej disa vjetësh mbulojnë të gjithë koston e investimit.
iv. Jetëgjatësia e një investimi (Sa më jetëgjatë të jetë ai aq më mirë është pasi, do të kërkojë vetëm fonde për mirëmbajtjen. Pra kostoja e investimit është vetëm kosto mirëmbajtjeje).
v. Gjeneron vende të reja pune duke zbutur kështu problemet sociale të qytetit.
vi. Numri dhe kategoritë e përfituesve i lartë
vii. Projekti/investimi është planifikuar nga qeveria qëndrore/ ministritë e linjës (mund të jetë në përputhje me politikat kapitale të qeverisë qëndrore, por që i shërben qytetit)
viii. I financuar nga donatorët (financim i plotë ose i pjesshëm)
ix. Projekti është në vazhdim (ai ka nisur zbatimin më parë)
x. Projekti mbështet strategjinë e zhvillimit ekonomik të qytetit

Por, ka edhe mënyra të tjera për të bërë prioritarizimin e projekteve në Planin e Investimeve Kapitale, duke i ndarë ato në kategori, dhe duke e bërë procesin përzgjedhës edhe më të lehtë. Megjithëse nuk ka një limit për kategorizimin e projekteve të Planit të Investimeve Kapitale, Investimet Kapitale mund të ndahen në disa kategori. Disa kategorizime të projekteve mund të jenë si më poshtë:

- I detyrueshëm / urgjent / i rëndësishëm

Në këtë kategori do të përfshihen ato projekte të cilat rregullojnë një gjendje të rrezikshme për shëndetin e komunitetit, sigurinë e tyre etj.

- I dëshirueshëm

Në këtë kategori mund të përfshihen projekte të cilat ruajnë ose përmirësojnë ambjentet ekzistuese duke bërë të mundur rritjen e standarteve të shërbimit dhe reduktimin e kostos së mirëmbajtjes dhe operative.

- I pranueshëm

Në këtë kategori do të përfshihen ato projekte të cilat mundësojnë të njëjtin standard të shërbimeve ose e përmirësojnë atë, përmirësojnë ambjentet ekzistuese, apo sigurojnë një shërbim të ri.

Që shtyhet në kohë

Në këtë kategori do të përfshihen ato projekte të cilat mund të shtyhen për më vonë, nuk janë urgjente, dhe ndoshta kanë nevojë për planifikim dhe analizë shtesë.

Tabela 6.

Kriteret për prioritarizimin e Investimeve Kapitale:
i. Projekti ka natyrë urgjente (p.sh. nëse rrezikohet jeta e banorëve të një blloku të caktuar, rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës i ujit të pijshëm do të shmangë epideminë në këtë lagje/bllok, etj.)
ii. Projektet, realizimi i të cilëve kushton mbi një vlerë, të përcaktuar nga grupi i PIK dhe njësia vendore.
iii. Zbatimi i projektit gjeneron të ardhura në buxhetin e njësisë vendore dhe këto të ardhura brenda një periudhe prej disa vjetësh mbulojnë të gjithë koston e investimit.
iv. Jetëgjatësia e një investimi (Sa më jetëgjatë të jetë ai aq më mirë është pasi, do të kërkojë vetëm fonde për mirëmbajtjen. Pra kostoja e investimit është vetëm kosto mirëmbajtjeje).
v. Gjeneron vende të reja pune duke zbutur kështu problemet sociale të qytetit.
vi. Numri dhe kategoritë e përfituesve i lartë

vii.	Projekti/investimi është planifikuar nga qeveria qëndrore/ ministritë e linjës (mund të jetë në përputhje me politikat kapitale të qeverisë qëndrore, por që i shërben qytetit)
viii.	I financuar nga donatorët (financim i plotë ose i pjesshëm)
ix.	Projekti është në vazhdim (ai ka nisur zbatimin më parë)
x.	Projekti mbështet strategjinë e zhvillimit ekonomik të qytetit

KAPITULLI VI
PËRGATITJA E DOKUMENTIT TË PIK

Proçesi i hartimit të PIK përfshin një dinamikë të gjerë veprimesh dhe aktorësh brenda dhe jashtë Bashkisë, angazhimi dhe kontributi të cilëve bëhet akoma më i rëndësishëm përgjatë zbatimit dhe monitorimit të tij. Realizimi i prioriteteve të përcaktuara në PIK sipas kalendarit të planifikuar dhe miratuar përqas akoma më shumë njësitë vendore me misionin dhe vizionin e përcaktuar në Planet Strategjike të Zhvillimit. Strategjia e Zhvillimit është një platformë e cila adreson zhvillimin imperativ të qytetit fokusuar jo vetëm në objektiva të lidhur me funksionet e vetë njësisë por edhe më gjerë në një perspektivë afatgjatë, ndërkohë që Plani Investimeve Kapitale është pikërisht instrumenti i cili materializon qëllimet dhe objektivat në inisiativa konkrete. Skema më poshtë sjell orientimin e këtyre proceseve në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të njësive vendore të miratuara në Planet Strategjike të Zhvillimit.

1.1 Përmbajtja e dokumentit të PIK dhe miratimi i tij

Në përfundim të procesit lehtësuesi i PIK (komiteti/grupi i punës për PIK) do të përgatisë një dokument, i cili përshkruan projektet e përzgjedhura, dhe ia komunikon ato në mënyrë të sintetizuar autoritetit lokal (kryetarit të njësisë dhe këshillit bashkiak) dhe qytetarëve. Dokumenti duhet të shprehë qartë procesin nëpërmjet të cilit është kaluar për përgatitjen e PIK dhe racionalen për përzgjedhjen e projekteve kapitale. Një plan shumëvjeçar i Investimeve Kapitale duhet të përfshijë minimalisht:

- Një kapitull hyrës, prezantues për njësinë e qeverisjes vendore, vizionin e saj për zhvillimin e qytetit/fshatit dhe të dhëna të tjera plotësuese

- Nje përmbledhje të shkurtër të metodologjisë dhe parimeve kryesore që kanë udhëhequr procesin e hartimit të PIK
- Një përmbledhje narrative, e cila përshkruan në përgjithësi procesin për hartimin e PIK dhe rezultatet e prioritarizimit të procesit
- Një përmbledhje të analizës së historikut financiar bashkiak, ku të jenë evidentuar tendencat kryesore në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e njësisë vendore
- Përmbledhje e analizës financiare në lidhje me parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë vendore në vitet e PIK
- Një panoramë të përgjithshme të projekteve të përzgjedhura dhe mekanizmave të financimit të tyre
- Një përmbledhje shpjeguese për secilin nga projektet
- Instrumentat e monitorimit të PIK mbështetur në burime (inpute), produkte (outpute) dhe rezultate (outcome)
- Çdo informacion tjetër të rëndësishëm në lidhje me procesin

Dokumenti i përgatitur, Plani shumëvjeçar i Investimeve Kapitale, prezantohet prej kryetarit të njësisë vendore (ose lehtesuesit të PIK) në Këshillin Bashkiak për diskutim dhe miratim. Dokumenti duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për vendimmarrësit për të mundësuar një vlerësim të saktë të procesit, projekteve dhe vendimeve, konform politikave lokale dhe qëndrore.

KAPITULLI VII
MONITORIMI I PIK

Ashtu si edhe çdo objektiv tjetër i njësisë të qeverisjes vendore, edhe plani i investimeve kapitale kërkon jo vetëm hartimin, miratimin dhe zbatimin e një kalendari aktivitetesh por edhe monitorimin e tij. Për të garantuar realizimin e PIK, si një proces që zgjat në kohë, është e domosdoshme që njësia e qeverisjes vendore dhe stafi i saj të bëjnë të mundur monitorimin e vazhdueshëm të këtij procesi. Gjatë hartimi të planit të investimeve kapitale, është përcaktuar "strategjia" e investimeve kapitale duke i dhënë përgjigje një sërë pyetjesh si: "Ku jemi?"; "Ku duam të shkojmë?"; "Kur duam të shkojmë?"; "Si do të shkojmë?"

Monitorimi i PIK shihet i lidhur ngushtësisht me inputet, outputet dhe outcomet të cilat mundësojnë vlerësimin mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të lidhur me misionin dhe qëllimin e programit respektiv.

Inpute – janë burimet financiare, njerëzore, pajisjet dhe mjetet të cilat vihen në dispozicion të realizimit të një outputi brenda një programi apo shërbimi specifik


Outpute – përshkruan një produkt të caktuar në terma sasiorë (numri i km të rrugëve të shtruara)

Efiçenca – është raporti midis inputit të përdorur për njësi të outputit ose kosto e outputit (kosto/njësi – kosto/km rrugë të rikonstruktuar)

Outcome – është rezultati i arritur nga realizimi i një outputi të caktuar bazuar në aspektet sasiore dhe cilësore të shërbimit (% e qytetarëve të cilët vlerësojnë se rruga është në kushte shumë të mira)

Skema më poshtë paraqet lidhjen midis këtyre elementëve brenda zhvillimit të projektit kapital dhe i referohet dokumentit të përdorur në monitorimin e Programit buxhetor afatmesëm në nivel qëndror.

Figura 4. Skema e monitorimit dhe vlerësimit të projekteve kapitale



Qëllimet dhe objektivat e PIK janë komponentët bazë për monitorimin dhe vlerësimin e projektit të lidhura me inputet, outputet dhe outcomet. Specifika e indikatorëve (SMART) të përdorur në monitorimin dhe vlerësimin e PIK lidhet me natyrën e tyre dhe konkretisht:

a) Specifik - lidhen me tregues konkretë të aktivitetit të njësisë
b) Të matshëm - evidentojnë nivelin e realizimit të treguesve dhe aktiviteteve
c) Të arritshëm – indikatorët e lidhur me evidentimin e kostos, mënyrën e mbulimit të financimit të projekteve e bëjnë atë të arritshëm
d) Real – përsa kohë evidentohen si prioritete të komunitetit vlerësohen realiste

e) Të strukturuar në kohë – planifikimi i projekteve kapitale për çdo vit e bën atë të strukturuar në kohë

Për të qenë më të përgjegjshëm dhe të mirë orientuar në përdorimin e burimeve financiare në dispozicion, është shumë e rëndësishme të vlerësohet si po përdoren ato. Në këtë aspekt, monitorimi dhe vlerësimi marrin rëndësi jo vetëm për matjen e nivelit të realizimit të objektivave të PIK por mbi të gjitha ato orientojnë politikat buxhetore për periudhën afatmesme.

Përveç sa më sipër, monitorimi i PIK mund të bëhet në shumë mënyra, disa prej të cilave janë renditur më poshtë:

i. Një prej mënyrave bazohet në elementët sasiorë të përmbushur në PIK (numri i objekteve të realizuar në kohën e planifikuar)
ii. Një mënyrë tjetër është edhe monitorimi në kohë dhe me cilësi i çdo aktiviteti apo investimi të planifikuar sipas ndarjes së fazave të investimeve
iii. Një tjetër mënyrë ka të bëjë me vlerësimin e kritereve të përcaktuara gjatë përzgjedhjes së projekteve të PIK. Mbi këtë bazë mund të matet edhe impakti i investimit kapital ose:

- Sa dhe si është përmbushur objektivi i strategjisë së zhvillimit të qytetit në sajë të investimit kapital të kryer (p.sh matja e kënaqshmërisë qytetare në lidhje me çështjen që zgjidh investimi kapital mund të jetë një tregues)
- Si janë të ardhurat e gjeneruara nga ky investim? A janë ato sipas planifikimit të bërë nga njësia vendore?
- A ka mundur njësia vendore të mbulojë vlerën e investimit nga të ardhurat e gjeneruara brenda periudhës që është

parashikuar?

- A janë përdorur burimet financiare të Bashkisë në mënyrë efiçente?
- Si dhe sa janë përmbushur nevojat dhe kërkesat e komunitetit?

Për sa kohë, Plani i Investimeve Kapitale në tërësinë e vet përfshin komponentë financiarë, monitorimi dhe vlerësimi i tij lidhet me treguesit e lidhur me: a) realizimin e buxhetit; b) realizimin e të ardhurave; c) politikat specifike të lidhura me burimet financiare; d) realizimin e shpenzimeve operative; e) fondet kapitale; f) transfertat; g) shuma e fondeve të veta për projektet kapitale; si dhe indikatorë të lidhur me h) vlerësimin e projekteve kapitale të planifikuara dhe të realizuara; j) kostot etj (*Aneksi 11* – Matricë indikatorësh për monitorimin e performancës së PIK).

KAPITULLI VIII
PLANI I VEPRIMIT DHE KALENDARI PËR HARTIMIN E PIK

Me qëllim hartimin, miratimin, zbatimin e planit të investimeve kapitale është e nevojshme të hartohet edhe një Plan Veprimi i shoqëruar me kalendarin e aktiviteteve sipas të cilave do të zbatohet proçesi. Në këtë Plan Veprimi duhet të identifikohen: (i) aktivitetet; (ii) afatet; (iii) personat përgjegjës, etj. Ky plan veprimi është i nevojshëm të hartohet dhe të ndiqet pasi jo vetëm identifikon në ç'fazë të proçesit të hartimit të PIK ndodhet njësia, por edhe se ku dëshiron të shkojë, si do të shkojë, çfarë duhet të bëjë, etj. Nga ana tjetër, ky plan veprimi e bën planin e investimeve kapitale të matshëm, pra na jep mundësinë të monitorojmë proçesin.
Një model i planit të veprimit dhe kalendarit për hartimin dhe realizimin e PIK në një afat kohor prej 12 muajsh, mund të jetë si më poshtë:

Janar: Në muajin Janar, kryetari i njësisë vendore dhe këshillit të njësisë grumbullojnë informacionin nga komuniteti dhe biznesi nëpërmjet mbledhjeve të hapura, komisioneve këshilluese, anketimeve etj. Mbi bazën e informacionit të marrë, ata, përcaktojnë politikat kapitale të vitit të cilat më pas do të udhëheqin proçesin e hartimit të PIK.
Po në fillim të vitit, pasi të jetë formuar dhe legjitimuar, grupi lehtësues i PIK, duhet të fillojë punën për të mundësuar:

- Parashikimin e fondeve në dispozicion për projekte kapitale
- Identifikimin dhe analizimin e burimeve të financimit të investimeve
- Rishikimin e politikave të zbatimit dhe raportimit në lidhje me PIK
- Shpërndarjen e udhëzimeve dhe formularëve për kërkesat e projekteve kapitale për drejtoritë e njësisë vendore dhe ndërmarrjet në varësi

Shkurt/Mars: Mbi bazën e udhëzimeve dhe formularëve për kërkesat e projekteve kapitale që janë shpërndarë në muajin Janar nga grupi i punës së PIK, të gjitha drejtoritë e njësisë dhe ndërmarrjet në varësi të saj duhet të përgatisin dhe dorëzojnë kërkesat e tyre pranë grupit të punës së PIK.

Mars/Prill: Në këtë periudhë, pasi formularët për investime kapitale janë plotësuar dhe dorëzuar, grupi i punës së PIK vazhdon punën për hartimin e PIK duke zbatuar hapat si më poshtë:

- Rishikon dhe raporton mbi zbatimin e planit të aktiviteteve për periudhën 3 – 6 mujore, por jo më vonë se 6 mujore
- Shqyrton projektet paraprakisht

Ky është një proçes i cili do të shërbejë si fillimi i punës për grumbullimin e materialeve, njohjen e situatës dhe vlerësimin e saj. Në këtë proçes duhet të përfshihen: (i) departamenti / zyra ekonomike; (ii) departamenti / zyra e urbanistikës; (iii) departamenti / zyra e projektimeve; (iv) departamenti / zyra e planifikim zhvillimit; të cilat bëjnë një shqyrtim teknik të kërkesave të paraqitura.

Prill/Maj: Gjatë kësaj periudhe, është shumë e rëndësishme që grupi i punës së PIK të plotësojë aktivitetet si më poshtë:

- Caktimin e prioriteteve dhe perzgjedhjen e projekteve kapitale të cilat do të përfshihen në PIK
- Përcaktimin e buxhetit kapital në dispozicion të njësisë vendore duke marrë parasysh edhe parashikimin e të ardhurave sipas buxhetit afatmesën që dorëzohet në fillim të muajit Qershor
- Akordimin e fondeve të disponueshme dhe programimin e projekteve
- Përgatitjen e draftit të PIK disa vjeçar

Qershor/Korrik: Gjatë kësaj periudhe, kryetari i bashkisë, këshillit bashkiak dhe stafi i PIK organizojnë mbledhje të hapura me komunitetin

mbi PIK-un e propozuar, diskutojnë dhe në fund aprovojnë draftin e PIK si një dokument të planifikimit të investimeve. Grupi i punës për hartimin e PIK duhet të përfshijë planin e vitit të parë të PIK-ut si pjesë përbërëse të buxhetit të njësisë. (Të gjitha investimet e parashikuara në buxhet për t'u kryer në vitin e parë, do të përfshihen në PIK)

Gusht/Shtator: Njësia vendore/këshilli i saj shqyrton dhe/ose miraton projektet disa vjeçare të PIK. Të paktën projektet kapitale të parashikuara për vitin e parë do të merren si pjesë integrale e buxhetit të njësisë, pa përmendur këtu faktin se në hartimin e projekt-buxhetit njësia duhet të bëjë një parashikim të të gjithë aktiviteteve për një periudhë disa vjeçare (minimumi 3 vjet). Në këtë periudhë parashikohet fianlizimi i projekt – buxhetit dhe miratimi paraprak i tij.

Tetor/Nëntor: Grupi i punës bën rishikimin e PIK dhe buxhetin kapital vjetor. Duke u bazuar në buxhetin kapital vjetor, grupi i punës, bën edhe parashikimin e projekteve kapitale për financim. Kemi parasysh faktin që në këtë periudhë njësitë mund të marrin informacion në lidhje me transfertën e kushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar që do të delegohet nga qeveria qëndrore në vitin pasardhës. I gjithë materiali i përgatitur i paraqitet për diskutim e miratim të gjithë aktorëve që lidhen me këtë proçes.

Dhjetor: Në këtë periudhë materiali i paraqitet këshilli të njësisë vendore, i cili bën miratimin e tij e pas këtij miratimi, kryetari i njësisë vendore dhe kryetari i këshillit nënshkruajnë buxhetin dhe planin e investimeve kapitale për vitet në vazhdim.

Anekse

Aneksi 1	Planifikimi i Buxhetit Oprerativ
Aneksi 2	Parashikimi Buxhetit Kapital
Aneksi 3	Llogaritja Analitike e të Ardhurave
Aneksi 4	Parashikimi i fondeve të mundëshme të Bashkisë
Aneksi 5	Mënyra e financimit të investimeve kapitale në vite
Aneksi 6	Ndarja e Buxhetit vjetor për Investime Kapitale
Aneksi 7	Metoda e vlerësimit mbi bazë kriteresh të projekteve
Aneksi 8	Formularë identifikimi të Projekteve
Aneksi 9	Tabelë Përmbledhëse e Investimeve Kapitale
Aneksi 10	Lidhja e PIK me Programin Buxhetor Afatmesëm
Aneksi 11	Matricë indikatorësh për monitorimin e performancës së PIK

Aneksi 1. Planifikimi i Buxhetit Operativ						*000/lekë*	
	PLANIFIKIMI I BUXHETIT OPERATIV	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**
I	**Llogaritja e tп Ardhurave Operative**						
A	Të trashëguara nga viti i mëparshëm						
B	Taksa e Tatime Vendore						
C	Tarifat Vendore						
D	Të ardhura të tjera						
E	Taksat e Tatimet e ndara						
F	Transferta e Pakushtëzuar						
I.I	**Shuma e tп ardhurave tп pakushtпzuara**						
G	Transferta e Kushtëzuar						
I.II	**TOTALI TП ARDHURAVE**						
II	**SHPENZIMET OPERATIVE**						
A	Pagat dhe shtesat mbi pagë						
B	Kontributi Sigurime Shoqërore e Shëndetësore						
C	Shpenzime Operative dhe Mirëmbajtjeje						
D	Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia						
E	Subvencione						
F	Fondi Rezervë 3%						
II.I	**TOTALI SHPENZIMEVE**						
III	**PARASHIKIMI I MBETJES OPERATIVE (I - II)**						
IV	**% e mbetjes operat./të ardhura operat. (III/I)**						

Aneks 2: Parashikimi i Buxhetit Kapital						000/lekë	
	PARASHIKIMI I BUXHETIT KAPITAL	2007	2008	2009	2010	2011	2012
I	TË ARDHURAT KAPITALE						
1	Mbetja operative e planifikuar						
2	Të ardhura nga shitja e pronave						
3	Hua						
4	Rezerva e kapitalit të trashëguar						
5	Shuma të ardhura të pakushtëzuara						
6	Transferta e kushtëzuar për investime						
7	Ndihma ose Donacione						
	TOTALI						
II	SHPENZIMET KAPITALE	2007	2008	2009	2010	2011	2012
1	Riparime						
2	Zëvendësime						
3	Pajisje të reja						
4	Ndërtim - montime						
5	Toka						
6	Studime/Projektime						
7	Rezerva Kapitale						
	TOTALI						

Aneksi 3. Llogaritja Analitike e të Ardhurave						000/lekë	
	TË ARDHURAT	2007	2008	2009	2010	2011	2012
	TAKSA VENDORE						
1	Taksa mbi Pasurinë						
1.1	*Taksa mbi Ndërtesat*						
1.2	*Taksa mbi Tokën Bujqësore*						
2	Taksa mbi Biznesin e Vogël						
3	Taksë Tabele						
4	Taksa e Rregjistrimit të Automjeteve						
5	Taksë zënie hapësire Publike						
6	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë						
7	Taksa e Kalimit të Pronësisë						
8	Taksë Fjetje në Hotel						
B	TARIFAT VENDORE						
1	Tarifë Pastrimi						
2	Tarifë Gjelbërimi						
3	Tarifë Ndriçimi						
4	Liçenca, leje, autorizime (transport,reklame,etj)						
5	Tarifë Therrje Bagëtie						
6	Tarifë Rregjistrimi						
7	Tarifa te tjera te miratuara nga Njesia Vendore						
8	Tarifë Gjuetie dhe Peshkimi Amator						
9	Tarifë Parkimi Automjete						
C	Të Ardhura të tjera						
1	Qera Trualli						
2	Qera Objekti + Veprimtari Ekonomike						
3	Shitje e Qera Trualli						
4	Blerje Trualli						
5	Dhurata/Sponsorizime						
6	Donacione						
7	Të tjera (interesa, gjoba)						
8	Garanci punimesh						
D	Pagesa						
1	Të prindërve për kopështet e fëmijëve						
2	Të prindërve për çerdhet e fëmijëve						
3	Të prindërve për konviktet						
E	Grant + Të Ardhura të Trashëguara						
F	Taksa e Tatime të ndara						
G	Transferta e Pakushtëzuar						
H	Transferta e Kushtëzuar						
1	Arsimi						
2	Shërbimi Shëndetësor						
3	Kujdesi Social						
4	Rendi Publik						
5	Mbrojtja e Mjedisit						
6	Gjendja Civile						
7	Sekretare Deputetit						
8	Subvencionet						
9	Zyra Gjendjes Civile						
	Investime nga Buxheti Shtetit						
I	Të Ardhurat Kapitale						
1	Shitje prone						
	TOTALI (A+B+C+D+E+F+G+H)						

Aneks 4: Parashikimi i fondeve të mundshme të veta									
PARASHIKIMI I FONDEVE TË MUNDSHME TË VETA									
ne mijë lekë	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Të ardhura të zakonshme të veta vendore									
- transferta e pakushtëzuar									
- taksat dhe tarifat e veta vendore									
Të ardhurat e zakonshme të pushtetit vendor në total									
Shpenzimet korente (funksionet e veta)									
Këshilli Bashkiak									
Administrata e Përgjithshme									
Arsimi									
Kultura dhe Sporti									
Shëndetësia									
Përkrahja Sociale									
Parqet dhe Varrezat									
Pastrimi & Mbetjet e ngurta									
Punët Publike									
Transporti Publik									
Gjendja Civile									
Të gjitha shpenzimet e tjera									
Shpenzimet korrente në total									
Fondet e mbetura të pushtetit vendor									

Aneksi 5: Financimi i Projekteve Kapitale në vite								000/lekë	
				Shpërndarja e Investimit					
Nr.	Përshkrimi i Investimit Kapital	Projekti	Vlera e Investimit	2008	2009	2010	2011	2012	Komente
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
	Vlera e Investimeve Kapitale/vit								

Aneksi 6: Ndarja e Buxhetit Vjetor për Investime Kapitale								Viti 20XX	
Nr	Përshkrimi i Investimit Kapital	Vlera e Investimit	Vlera e Investimit në vitin aktual	Burimi i të Ardhurave					
				Të Ardhura	Grant i Pakushtëzuar	Grant i Kushtëzuar	Donator	Hua	Total
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
	Vlera në total								

Aneksi 7: Tabela e Vlerësimit me Pikë të Projekteve

Nr.	Përshkrimi i Investimit	Kosto/nr. Përfituesve	Rritja Ekonomike	KRITERET E PLOTËSUARA						Shuma e pikëve
				Lidhja me prioritetet	Natyra urgjente	Ndikon ne parandalimin emergjencave	Projekt në vazhdim	Shpërndarja gjeografike	Kohëzgjatja e shlyerjes së kostos	
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
11										
12										

Aneksi 8: Formulari i Evidentimit të Projektit

PROPOZIM INVESTIMI

01. Pikat e kontaktit

Institucioni buxhetor	Drejtoria
Grupi lehtësues i PIK	Kontakti për grupin e PIK
Personi i kontaktit në grupin e PIK	Kontakti i personit të PIK

02. Identifikimi i Investimit

Ministria/grupi/sektori (Institucioni buxhetor)	**Kodi i Grupit**
Emri i Programit	Kodi i Titullit (Programit)
Emri i Projektit	Kodi i Projektit
	Numri i identifikimit (DMIP)
	Vendndodhja
Statusi i projektit	Status i financimit nga donatori (nëse ka)
Data e fillimit	Data e përfundimit

03. Justifikimi i Investimit

Nevoja për investimin/ Problematika e gjendjes aktuale
Arsyet për ndërhyrjen
Përputhja e projektit me Strategjinë e Qytetit/ Qëllimet e programit

04. Formulimi i Projektit

Emri i projektit
Përshkrimi i projektit
Objektivat e projektit
Rezultatet/përfitimet e projektit
Indikatorët e projektit. Do të riparohen xxx m2 rrugë, etj

05. Kostot e mëparshme të projektit

Kosto e investimit deri në fund të 200__ (nëse ka patur), 000/lekë	Kosto e parashikuar deri në fund të 200__ (nëse ka), 000/lekë

06. Kostot shtesë të investimit/ Të ardhurat e Projektit

Kostot e Projektit	Kosto totale e projektit 000/lekë	2008 000/lekë	2009 000/lekë	20010 000/lekë	Kosto e mbetur e invest. 000/lekë
(a) Kosto e Investimit (230-232)					
(b)Shpenzime periodike si rezultat i zbatimit të investimit					
(c) Totali i kostove					
(d) Të ardhurat nga zbatimi i Projektit (nqs ka)					
(e) Financimi nga Donatori (nqs ka)					
(f) Kostoja Neto					

07. Menaxhimi i projektit dhe rreziqet e para - kushtet e realizimit të investimit

Rreziqet dhe Supozimet gjatë zbatimit dhe realizimit të projektit dhe veprimet parandaluese të planifikuara	
Përmbledhje e menaxhimit dhe organizimit të zbatimit të projektit	
Plani i projektit i zhvilluar Po / Jo Projekt idea e zhvilluar Po / Jo	Studimi i fizibilitetit i zhvilluar Po/Jo Analiza të tjera ekonomike-financiare Po/Jo

08. Vlerësime të tjera

Vlerësime të impaktit të investimit në fusha të tjera	
Vlerësimi mjedisor	Po / Jo / Të panevojshme
Vlerësimi i impaktit social të investimit	Po / Jo / Të panevojshme
Të tjera (specifiko)	Po / Jo

09. Informacione të tjera

Komente të tjera

10. Autorizuesit / Nivelet e vlerësimit / aprovimit të projektit

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit/ *Statusi i Projektit*
Drejtuesi i grupit lehtësues të PIK				Aprovimi për tu shqyrtuar më tej *Projekti i propozuar si prioritar*
Komente nga Drejtuesi i grupit të PIK (nqs ka)				
Shefi i financës i Institucionit Buxhetor/ përfaqësuesi në grupin e PIK				Aprovimi i kostos së projektit *Kostoja e vlerësuar nga Institucioni Buxhetor*
Komente nga Buxheti dhe Financa i Institucionit Buxhetor (nqs ka)				
Drejtuesi i Institucionit buxhetor				Konfirmimi i prioritetit të projektit *Aprovuar/Refuzuar nga Institucionit Buxhetor*
Komente nga Drejtuesi i Institucionit Buxhetor (nqs ka)				
Fotografi				

Aneksi 9: Përmbledhëse e Investimeve Kapitale

Nr	Projektet/Përshkrimi	Preventivi në *000/lekë*	Burimi i Financimit	Planifikimi		Objektivi / Rezultatet e pritshme
				Fazat	Viti për çdo fazë	
1				Studim		
				Projektim		
				Tenderim		
				Ndertim		
2				Studim		
				Projektim		
				Tenderim		
				Ndertim		
3				Studim		
				Projektim		
				Tenderim		
				Ndertim		
4				Studim		
				Projektim		
				Tenderim		
				Ndertim		
5				Studim		
				Projektim		
				Tenderim		
				Ndertim		

Aneksi 10. Lidhja e PIK me PBA

Programi: Arsimi para shkollor

Objektivi: Të organizojmë shërbimin e arsimit para-shkollor për të gjithë fëmijët e qytetit tonë për t'u dhënë atyre akses në edukimin cilësor

Qëllimi: Të përmirësojmë shërbim arsimor parashkollor për komunitetin tonë Brenda vitit 2013

Objektivi Strategjik	**Inpute**	**Outpute**	
Brenda vitit 2011 do të rritet numri i fëmijëve në kopështin nr.3 nga 40 në vitin 2010 në 50 në vitin 2011	1,500	1 kopësht i rikonstruktuar 10 shtetër të rinj Etj.	Arsimi parashkollor është përmirësuar me një kopësht të rikonstruktuar

Aktivitetet	**Kostot**
1) Përgatitja e dokumentave të projektit dhe preventive	250
2) Përgatitja e dokumentave të tenderit	50
3) Tenderimi	100
4) Kontraktimi	0
5) Rikonstruksioni i kopështit 3	1 100
6) Pajisje të reja	200
Kosto Totale	**700**

Aneksi 11. Matricë indikatorësh për monitorimin e performancës së PIK					
Indikatorë të lidhur me:	**Komponentët e vlerësuar**	**Viti bazë**	**Viti monitoruar**	**Krahasimi**	**Konstatime/ Komente**
Performancлn e Buxhetit tл Bashkisл	a) realizimi i buxhetit				
	b) shpërndarja e buxhetit për banorë				
	c) realizimi i taksave vendore				
	d) realizimi i tarifave vendore				
	e) të ardhura të trashëguara				
	f) transferta e pakushtëzuar				
	g) transferta e pakushtëzuar/banorë				
Taksapaguesit - biznese - familjarë	h) subjekte biznesi vogël				
	i) subjekte biznesi madh				
	j) të ardhura nga abonentët familjarë				
	k) të ardhura vetëm taksë ndërtese				
Shpenzimet - operative - kapitale	l) shpenzimet operative e mirëmbajtjes				
	ll) shpërndarja e shpenzimeve / banorë				
	m) shpenzime kapitale				
	- shpenzime kapitale Grant Konkurues				
	- shpenzime kapitale të ardh. e veta				
	n) shpenzime kapitale / banorë				
Projektet Kapitale tл parashikuara пл PIK	p) projekte të planifikuara				
	q) projekte të realizuara				
	r) % - ja e realizimit të PIK				
	s) projekte në vazhdim				
	sh) projekte të parealizuara				
Kosto e projekteve kapitale	t) kosto e planifikuar				
	th) kosto e realizuar				
	u) % - je e realizimit				
	v) kosto e pafinancuar				
Politikat specifike tл tл ardhurave	z) burime të reja (subjekte të reja)				
	- biznesi vogël				
	- biznesi madh				
	y) zvogëlimi burimeve				
	- biznesi vogël				
	- biznesi madh				
	x) rritja/ulja e bazës së taksueshme				

Referencat

Agjensia e Prokurimeve Publike, Manual per Sherbimin e Prokurimeve Publike. Pjesa I. 2006.

Conway, F. et al. 1999. "Romania Capital Investment Planning", A self study guide, USAID, East European Regional Housing Sector Assistance Project. October 1999

Gues, G. et al. 2004. "CIP and Budgeting Toolkit", USAID Governance Reform and Sustainable Partnerships Program (GRASP), Rumania. December 2004.

Locsmándi, G. & Péteri, G. and Varga-Ötvös, B. 2000. "Urban Planning and Capital Investment financing in Hungary". OSI/LGI, Budapest DEBASCON, 2010. "Programi Buxhetor afatmesëm 2011 – 2013"

RTI International, 2006. "Capital Investment Planning". Municipal Finance task Force, 2006.

Swianiewicz, P. et al. 2004. "Local Government Borrowing: Risks and Rewards", A report on Central and Eastern Europe, OSI/LGI, Budapest

The Research Triangle Institute, 1999. Handbook on borrowing for city development. USAID Program, 1999.

World Bank, 2008. Local Finance Policy note. September, 2008.